



UDHËRRËFYES PËR NDIHMËN LIGJORE MIQËSORE NDAJ FËMIJËVE NË KONFLIKT ME LIGJIN

*Rekomandime dhe praktika pozitive
për hartuesit e politikave dhe avokatët*



NDIHMJA LIGJORE PËR TË MITURIT NË KONFLIKT ME LIGJIN:
HARTIMI I PRAKTIKAVE POZITIVE (LA CHILD)

UDHËRRËFYES PËR NDIHMËN LIGJORE MIQËSORE NDAJ FËMIJËVE NË KONFLIKT ME LIGJIN

*Rekomandime dhe praktika pozitive
për hartuesit e politikave dhe avokatët*

LA CHILD



The project is funded by the Justice Programme of the European Union (2014-2020)



- * Ky dokument është përgatitur në kuadër të projektit “Ndihma juridike për fëmijët në procedimet penale: Zhvillimi dhe ndarja e praktikave më të mira (LA CHILD) i financuar nga Program i Drejtësisë së Komisionit Europian. Përmbajtja e këtij dokumenti nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e Komisionit Europian dhe nuk nënkupton në asnjë mënyrë konfirmimin e pikëpamjeve të shprehura në këtë raport. Nëse në këtë dokument gjenden pasaktësi apo gabime, ato i atribuohen autorëve të tij.
- * © 2020-2021, projekti «LA CHILD »
- * Original version designed by Olivia Olbrechtsand.
- * Albanian version design and Print by AP Studio
- * ISBN 978-99956-32-90-8

PASQYRA E PËRMBAJTJES

Parathënie	9
HYRJE	10
Objektivat e këtij Udhëzuesi	10
Kujt i drejtohet ky Udhëzues?	10
Si ta përdorim këtë Udhëzues?	11
Projekti dhe autorët	12
Mirënjohja	12
PËRKUFIZIME KYÇ	13
• Fëmijë	13
• Fëmijë në konflikt me ligjin	13
• Sistemi i drejtësisë për fëmijë	13
• Ndhmë Juridike	13
• Autoritetet e ndihmës juridike	13
• Ofrues i ndihmës juridike	13
• Ndhmë juridike parësore dhe dytësore	13
UDHËZUES PËR POLITIKBËRËS	15
1. Kuadri ligjor që përmban masat specifike mbi ndihmën juridike për fëmijët në konflikt me ligjin	16
2. Akordimi i burimeve publike të përshtatshme për ndihmën juridike për fëmijë	17
3. Ndhmë juridike falas dhe e pakushtëzuar për çdo fëmijë në konflikt me ligjin	19
4. Përfaqësimi i fëmijëve përgjatë gjithë fazave të procedimeve ligjore	20
5. Akses efektiv në ndihmën juridike për fëmijët e privuar nga liria	22
6. Kufizim dhe kontroll strikt mbi refuzimin e ndihmës juridike	24
7. Avokatë të specializuar për fëmijë	25
8. Trajnimi i detyrueshëm fillestar dhe vazhdues për avokatët e të miturve	27
9. Promovimi i bashkëpunimit midis aktorëve që ndihmojnë dhe mbështesin fëmijët në procedura ligjore	29
10. E drejta për përkthim	30

11. Konfidencialiteti dhe privatësia e komunikimit midis fëmijës dhe ofruesit të ndihmës juridike	31
12. Zgjedhja e lirë e avokatit	32
13. Mundësia e ndërrimit të avokatit	34
14. Fëmijët në nevojë për ndihmë të specializuar në fusha të ndryshme të ndihmës juridike	36
15. Informacion i përshtatshëm për fëmijët rreth ndihmës juridike për fëmijët në konflikt me ligjin	37
16. Informacion rreth ndihmës juridike	39
17. Standarte për avokatët e ndihmës juridike që punojnë me fëmijë	40
18. Monitorimi i ndihmës juridike i ofruar për fëmijët dhe procedurat e ankimit	42
Hyrja: Të sigurojmë që interesi më i lartë i fëmijës është konsideratë parësore	46
19. Disponueshmëria dhe pjesëmarrja e ofruesit të ndihmës juridike në çdo fazë të procedurës	47
20. Mbrojtja e Fëmijës	48
21. Aksesit në informacionin e duhur	49
22. Roli i avokatit si përfaqësues i zërit të fëmijës	51
23. Përfaqësimi i fëmijës, jo i prindërve të tij/saj apo kujdestarëve ligjor	53
24. Sigurimi i konfidencialitetit	54
25. Përfaqësimi i një fëmije të privuar nga liria	55
26. Nevoja për trajnime vazhduese multidisiplinare	57
27. Komunikimi miqësor me fëmijët	59
28. Marrëdhënia e bazuar tek besimi	61
29. Prgatitja e intervistës me fëmijën	63
30. Bashkëpunimi me familjen dhe profesionistë të tjerë në interesin më të lartë të fëmijës	67
31. Bashkëpunimi me një përkthyes	69
32. Fëmijët në nevojë për asistencë juridike të specializuar në fusha të ndryshme ligjore	72
STANDARTET KRYESORE EUROPIANE DHE NDËRKOMBËTARE LIDHUR ME NDIHMËN JURIDIKE PËR FËMIJËT NË KONFLIKT ME LIGJIN	74
Legjislacion Zbatues	74
Legjislacion Jo Detyrues	75
Burime të tjera	75

Parathënie

Për një kohë të gjatë, fëmijët, vecanërisht ata në konflikt me ligjin, nuk janë konsideruar si mbartës të të drejtave sikundër të rriturit dhe nevojat e tyre të vecanta janë nënvlerësuar. Pohime të ndryshme janë përdorur për të justifikuar këtë qëndrim si për shembull “ fëmijët janë shumë të rinj për të kuptuar”, “ të rriturit duhet të vendosin për fëmijët”, “ gjyqtari është përgjegjës për të mbrojtur interesin më të lartë të fëmijës” apo “ ai/ajo nuk ka nevojë për avokat”.

Historikisht mbrojtja e fëmijëve në gjykatë është kryer nga avokatë vullnetarë të cilët e ofronin shërbimin për bamirësi. Për më tepër, ata shpesh ishin avokatë të rinj të pa specializuar të cilët mësonin profesionin e tyre “ në kurriz të klienteve të tyre të mitur”. Ne tani e dime, dhe ky udhërrëfyes e tregon dukshëm se dikush nuk mund të vetë konsiderohet si avokat për fëmijët, dhe se ky funksion është po aq kompleks sa shërbimet e tjera që ofrojnë avokatët.

Fatmirësisht, sistemi gradualisht po përmirësohet falë punës së palodhur të disa avokatëve të cilët i kanë kuptuar karakteristikat dhe kërkesat e këtij pozicioni kanë përmirësuar cilësinë e shërbimit dhe kanë filluar të krijojnë sektorin e avokatit për fëmijët. Gjithashtu, falë dhe evoluimit të standardeve dhe qartësisht të juridiksioneve ndërkombëtare të cilat janë bërë gjithmonë e më specifike në lidhje me atë çfarë kërkohet nga avokatët për fëmijët, cilësisë së kërkuar dhe rëndësisë së dhënë ndaj trajnimeve multidiciplinare.

Për të garantuar një shërbim cilësor, falas, të mundshëm dhe të përshtatshëm për të gjithë fëmijët, është thelbësore që autoritetet shtetërore të cilat janë përgjegjëset kryesore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, të zbatojnë një sistem ligjor që lejon respektimin e plotë të standardeve të përmendura në këtë udhërrëfyes. Ne nuk mund thjesht të mbështetemi tek vullneti i mirë i disa njerëzve.

Një gjë e rëndësishme për këtë udhërrëfyes është se ai jo vetëm identifikon modelet kryesore të ndihmës ligjore për fëmijët dhe specifikat e rolit të avokatit të angazhuar në këtë fushë, por ofron shembuj praktikë dhe eksperiencë të marra nga disa vende. Bazuar në analizën e zhvilluar nga 14 shtete, projekti “ LA CHILD” ka identifikuar dhe pengesat kryesore për zhvillimin e një sistemi ligjor të denjë dhe ofron nëpërmjet këtij udhërrëfyesi ofron rekomandime të cilat ndihmojnë për t’i tejkaluar ato dhe përmirësojnë sistemin ligjor në tërësi.

Së fundi, është e nevojshme të theksojmë se ndërtimi i një sistemi të duhur drejtësie është në të njëjtën linjë me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, të adoptuar nga Kombet e Bashkuara në vitin 2015, në vecanti me objektivin 16.3 i cili synon “ të nxisë shoqëri të paqta dhe gjithëpërfshirëse për një zhvillim të qëndrueshëm, të garantojë akses në drejtësi për të gjithë, dhe të ndërtojë institucione efektive, llogaridhënëse dhe përfshirëse në të gjitha nivelet”. Për të arritur këtë qëllim, i cili është ingrediënti bazë për arritjen e gjithë agjendës së Kombeve të Bashkuara, 2030, është e nevojshëm krijimi i një sistemi ligjor eficient, miqësor për fëmijët dhe të përbërë nga avokatë të kualifikuar. Shpresoj që ky udhërrëfyes t’i shërbejë këtij qëllimi madhor.

Benoit Van Keirsbilck

Anëtar i Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës dhe Drejtor i Defence for Children, International, Belgjikë

HYRJJE

Objektivat e këtij Udhëzuesi

Ky Udhëzues ka si qëllim që t'i bëjë parimet dhe rekomandimet të aksesueshme për të gjithë aktorët që kanë ndikim në ndihmën juridike për fëmijë në konflikt me ligjin në Europë.

Udhëzuesi mbështetet në veçanti në studimin e realizuar në 14 vende europiane që zbatojnë projektin Ndhma Juridike për Fëmijë (LA CHILD) dhe praktikat frymëzuese të mbledhura përgjatë tij. Konferenca ndërkombëtare LA Child, në të cilën ekspertët nga vende të ndryshme kanë ndarë njohuritë dhe mendimet e tyre, ishte një burim i vlefshëm në hartimin e Udhëzuesit. Ky i mësuar i dyanshëm solli ide, të cilat na kanë bërë të mundur të ecim para në fushën e ndihmës juridike për fëmijët në konflikt me ligjin.

Kujt i drejtohet ky Udhëzues?

Ky udhëzues është hartuar për të gjithë profesionistët, të cilët ndërhyjnë apo kanë ndikim në ndihmën juridike për fëmijët në konflikt me ligjin. Së pari, ne shpresojmë që ai do të jetë një mjet praktik dhe i dobishëm për të gjithë avokatët që ofrojnë asistencë juridike për fëmijët në konflikt me ligjin. Udhëzuesi mund t'i ndihmojnë ata për tu ndërgjegjësuar më shumë mbi standartet ndërkombëtare dhe Europiane, për të reflektuar mbi praktikën e tyre dhe të gjejnë praktika të tjera frymëzuese dhe rekomandime që mund të ndihmojnë në përmirësimin e saj.

Së dyti, duke qenë se ndihma juridike miqësore ndaj fëmijëve mbështetet gjithashtu në një sistem global dhe në organizimin efektiv të ndihmës juridike, politikëbërësit dhe autoritetet e ndihmës juridike duhet të jenë lexues të kujdesshëm të këtij Udhëzuesi. Qëllimi është prezantimi, në një dokument të qartë i praktikës më të mirë për fushën e ndihmës juridike për fëmijët në konflikt me ligjin, si dhe të prezantimit të mënyrave konkrete të arritjes së saj.

Si ta përdorim këtë Udhëzues?

Në këtë Udhëzues janë identifikuar, listuar dhe shpjeguar 32 faktorë kyç për ndihmë juridike miqësore për fëmijët. Në secilin faktor, lexuesi mund të gjejë:

- Referenca lidhur me standartet europiane dhe ndërkombëtare që ofrojnë udhëzime;
- Përfitimet e përdorimit të secilit faktor kyç duke respektuar të drejtat e fëmijëve, por edhe pengesat e ndryshme me të cilat profesionistët mund të përballen, gjatë zbatimit të tij;
- Rekomandime konkrete për t'ju përgjigjur efektivisht çdo faktori kyç (thelbi i Udhëzuesit);
- Shembuj të praktikave të vëzhguara në vende të ndryshme Europiane që mund të frymëzojnë vende të tjera dhe/ose profesionistët.

Udhëzuesi është ndarë në 2 pjesë. Pjesa e parë iu drejtohet politikëbërësve dhe autoriteteve të ndihmës juridike. Pjesa e dytë iu drejtohet specifikisht avokatëve që punojnë me fëmijë në konflikt me ligjin dhe përmban sugjerime dhe këshilla praktike se si të ndihmohet një fëmijë në konflikt me ligjin.

Ikona:



Rekomandime



Praktika frymëzuese



Burim interesant



Dëshmi frymëzuese

Projekti dhe autorët

Ky Udhëzues është një nga produktet kryesore të Projektit të Ndhmës Juridike për Fëmijë (La Child). Ky projekt i bashkëfinancuar nga BE, Ndhma Juridike për fëmijët në procedime penale: zhvillimi dhe ndarja e praktikave më të mira (LA Child), vihet në zbatim nga “Law Institute of the Lithuanian Center

for Social Sciences”, Defence for Children International (DCI) – Belgjikë dhe nga Qendra për Shërbime dhe Praktika Ligjore të Integruara (QSHPLI, Shqipëri). Projekti filloi në Shkurt 2020 dhe do të mbarojë në Dhjetor 2021.

Objekti i përgjithshëm i projektit është të rrisë mbrojtjen e fëmijëve në konflikt me ligjin, duke ruajtur zbatimin koherent të Direktivës 2016/800 mbi masat procedurale për fëmijët në konflikt me ligjin.

Ky dokument është shkruajtur nga Dr. Agne Limante (Drejtoresh e Projektit – LIL), Dr. Simonas Nikartas (LIL), Dr. Ruta Vaiciuniene (LIL), Z. Klodian Gega (QSHPLI). Znj. Eva Gangneux (DCI - Belgjikë), Znj. Zoé Duthuillé (DCI - Belgjikë)

Të gjitha rezultatet e këtij projekti gjenden në faqen <https://latchild.eu>

Mirënjohja

Autorët do të donin të falenderonin të gjithë partnerët dhe ekspertët të përfshirë në Projektin Ndhma Juridike për Fëmijët (LA Child) për kontributin e tyre shumë të vlefshëm në përgatitjen e këtij Udhëzuesi.

Së pari, ne falenderojmë sektorin evropian pro-bono DLA Piper që ka koordinuar studimin në 11 vende në nivel kombëtar dhe avokatët e DLA Piper që kanë analizuar ndihmën juridike për fëmijë të këtyre vendeve.

Do të donim gjithashtu të falenderonim të gjithë profesionistët në Shqipëri, Belgjikë dhe Lituani që kanë pranuar të intervistohen për këtë projekt e që, duke ndarë përvojën e tyre si ofrues të ndihmës juridike për fëmijë në konflikt me ligjin, na kanë mundësuar të kuptuarin e mëtejshëm mbi realitetin dhe sfidat që përmban kjo punë.

Ne gjithashtu shprehim falenderimet tona më të sinqerta ndaj ekspertëve që kanë marrë pjesë në konferencën ndërkombëtare në Shkurt 2021; ndërhyrjet e tyre kanë qenë tejet të dobishme dhe konstruktive në kontekstin e përgatitjes së këtij Udhëzuesi.

Së fundmi, falenderimet tona shkojnë për kontribuesin kryesor financiar të këtij projekti, Programi i Drejtësisë së Bashkimit Evropian, pa të cilin ky projekt nuk do të ishte i mundur.

¹ Ligji Model mbi Ndhmën Juridike në Sistemet e Drejtësisë Penale. Kombet e Bashkuara. Vjenë, 2017: www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/LegalAid/Model_Law_on_Legal_Aid.pdf
² Ibid.

PËRKUFIZIME KYÇ

FËMIJË

Qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç.

FËMIJË NË KONFLIKT ME LIGJIN

Një person i cili ka arritur moshën e përgjegjesisë penale (16 vjeç), por jo moshën madhore (18 vjeç), që është i dyshuar apo akuzuar për kryerjen e një krimi sipas ligjit të vendit të tij/saj. (KDF/C/GC/10, Hyrje, §1) Moshë që duhet të merret në konsideratë për të përcaktuar nëse një fëmijë është në konflikt me ligjin është jo më vonë se moshë e individit në kohën e kryerjes së krimit.

SISTEMI I DREJTËSISË PËR FËMIJË

Legjislacioni, normat, standartet, procedurat, mekanizmat dhe masat që janë specifikisht të zbatueshme, si dhe institucionet dhe aktorët e ngarkuar për tu marrë me fëmijët, që konsiderohen si shkelës. (KDF/C/GC24, III. Terminologji, §8)

NDIHMË JURIDIKE

Ofrimi i këshillimit juridik, ndihmës dhe përfaqësimit me shpënzimet e shtetit në kushtet dhe në përputhje me procedurat e caktuara nën ligjin kombëtar për personat e ndaluar, arrestuar apo burgosur; për persona të dyshuar apo të akuzuar, akuzuar apo dënuar për një vepër penale; dhe për viktimat apo dëshmitarët në procesin e drejtësisë penale. Ndihma juridike përfshin

edukim ligjor, akses në informacion ligjor dhe shërbime të tjera të ofruara përmes mekanizmave alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe të proceseve të drejtësisë restauruese.¹

AUTORITETET E NDIHMËS JURIDIKE

Autoriteti i ngritur sipas ligjit vendas me qëllim menaxhimin, koordinimin dhe monitorimin e ofrimit të ndihmës juridike.²

OFRUES I NDIHMËS JURIDIKE

Çdo person që ofron ndihmë juridike në përputhje me ligjin e vendit

NDIHMË JURIDIKE PARËSORE DHE DYTËSORE

Në shumë vende Europiane, ndihma juridike organizohet në disa nivele. Dy nivelet kryesore janë ai i ndihmës juridike parësore dhe dytësore. Ndihma juridike parësore (linja e parë) përfshin konsultim dhe këshillim juridik në çështje ligjore, ndërkohë që ndihma juridike dytësore (linja e dytë) ka si qëllim ofrimin e asistencës në procedime para-gjyqësore dhe gjyqësore. Studimi mbi Ndihmës Juridike për Fëmijët (LA Child) fokusohet kryesisht në ndihmën juridike dytësore dhe për rrjedhojë, ky dokument i referohet ndihmës juridike dytësore, përjashtuar rasteve kur specifikohet ndryshe.

¹ Ligji Model mbi Ndihmën Juridike në Sistemet e Drejtësisë Penale. Kombet e Bashkuara. Vjenë, 2017: www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/LegalAid/Model_Law_on_Legal_Aid.pdf
² Ibid.

PJESA 1

UDHËRRËFYES PËR HARTUESIT E POLITIKAVE

1. Kuadri ligjor që përmban masat specifike mbi ndihmën juridike për fëmijët në konflikt me ligjin.

● STANDARTET E BE-SË DHE NDËRKOMBËTARE

Udhëzimet dhe Parimet e KB mbi aksesin në ndihmë juridike në sistemin e drejtësisë penale theksojnë se shtetet duhet të ndërmarrin masat e përshtatshme për të krijuar sisteme të ndihmës juridike miqësore dhe të ndjeshme ndaj fëmijëve. Ndër këto masa, ata përmendin ngritjen e mekanizmave të dedikuara për të mbështetur ndihmën juridike të specializuar për fëmijët; miratimin e legjislacionit për ndihmën juridike, politikave dhe rregulloreve që qartazi marrin në konsideratë të drejtat dhe nevojat e veçanta zhvillimore të fëmijëve, dhe krijimin e standarteve të shërbimeve të ndihmës juridike miqësore për fëmijët dhe kodeve profesionale të etikës. (Udhëzimi 11, §58).

● PËRFITIMET DHE SFIDAT

Përshtatja e kuadrit ligjor për të ndihmuar specifikisht fëmijët në procedime penale, përmirëson mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe sjell në vëmendje situatën e veçantë të këtij grupi vulnerabël. Vëmendja e veçantë tek e drejta e fëmijëve për ndihmë juridike dhe mbështetja e rritjes së mbrojtjes së këtyre të drejtave, rrit cilësinë e ndihmës juridike në përgjithësi.

Ndërsa, në disa vende Europiane gjejmë shpesh të paktën disa masa mbi specifikat e ndihmës juridike për fëmijët, në mjaft raste nevojitet një fokus i shtuar.



- Ndhimta juridike miqësore për fëmijët duhet të vendoset si një prioritet në legjislacionin dhe praktikën kombëtare. Ligjet duhet të përfshijnë standartet cilësore të një ndihmë juridike efektive, efçiente dhe miqësore për fëmijët.
- Ky parim nuk do të thotë gjithmonë se duhet të miratohet një akt ligjor i veçantë për ndihmën juridike për fëmijët. Sidoqoftë, legjislacioni vendas që rregullon ndihmën juridike duhet të ofrojë parashikime ligjore dedikuara qartazi të drejtës së fëmijës për ndihmë juridike dhe specifike të saj.
- Është i këshillueshëm zhvillimi i një kodi sjelljeje për ofruesit e ndihmës juridike (si dhe profesionistë të tjerë) të cilët punojnë me fëmijët nëkonflikt me ligjin.



Disa juridiksione europiane kanë një ligj të veçantë për drejtësinë për fëmijët dhe disa prej tyre përfshijnë në ligjin e përgjithshëm parashikime specifike në lidhje me fëmijët në konflikt me ligjin.

- ✳️ Në **Republikën Çeke**, Akti për Drejtësinë për të Mitur rregullon përgjegjësinë penale të fëmijëve, masat që merren si pasojë e një sjelljeje kriminale, si dhe procedurat e vendimmarrjen në çështjet respektive. Akti mbi Drejtësinë për të Mitur mund të konsiderohet si një rregullore e plotë për ndihmën juridike për fëmijët, si gjatë por edhe pas procedimeve penale.
- ✳️ Në **Shqipëri**, Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, i miratuar në 2017, rregullon ndihmën juridike për fëmijët dhe synon të përshtasë sistemin e drejtësisë penale me nevojat e fëmijëve.

2. Akordimi i burimeve publike të përshtatshme për ndihmën juridike për fëmijë

● STANDARTET E BE-SË DHE NDËRKOMBËTARE

Udhëzimet dhe Parimet e KB mbi aksesin në ndihmë juridike në sistemin e drejtësisë penale rekomandojnë se “Shtetet duhet ta konsiderojnë ofrimin e ndihmës juridike si detyrim dhe përgjegjësi të tyre”. Me këtë qëllim, ata duhet të marrin në konsideratë aprovimin e legjislacionit specifik dhe rregulloreve që të sigurojnë një sistem ndihme juridike që është gjithëpërfshirës, i aksesueshëm, efektiv, i qëndrueshëm dhe i besueshëm. Shtetet duhet të ofrojnë burimet njerëzore dhe financiare të nevojshme për sistemin e ndihmës juridike. (Parimi 2, §15).

● PËRFITIMET DHE SFIDAT

Megjithëse shtetet duhet të sigurojnë burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare për sistemin e ndihmës juridike, në praktikë, këto burime nuk janë gjithmonë mjaftueshme. Për shembull, një sondazh i realizuar në 2018 me 90 ekspertë të ndihmës juridike kombëtare nga 22 vende të BE, tregoi se vetëm 30 përqind e pjesëmarrësve besonin se sistemi i pagesës në ndihmën juridike kombëtare ishte i përshtatshëm.³

4 Burchard C., Jahn M., Zink S. Nikartas S., Limanté A., Totoraitis L., Banevičienė A., Jarmalė D. (2018) Practice standards for legal aid providers: https://teise.org/wp-content/uploads/2019/09/Qual-Aid_Practice-Standards_EN.pdf

Paga e ulët është një faktor i motivimit të pakët të avokatëve për të ofruar ndihmë juridike. Kjo është një pengesë e rëndësishme në përfshirjen e profesionistëve shumë të kualifikuar në ofrimin e ndihmës juridike.

Sfidat praktike të avokatëve janë të ndryshme. Për shembull, sipas avokatëve lituanezë që morën pjesë në studimin e projektit (LA Child), problemi kryesor nuk qëndron tek rroga për orë apo ajo mujore, por tek regjistrimi i orëve të punës dhe te ngarkesa burokratike që ajo sjell. Në mënyrë që të justifikojnë dhe përlllogarisin orët e shpenzuara në punë, ata duhet të plotësojnë disa dokumente, gjë e cila u merr kohë shtesë, edhe pse koha e dhënë në dispozicion për punën është e kufizuar. Për më tepër, avokatët raportuan se koha e kufizuar e vendosur për një detyrë specifike i dekurajon ata dhe i pengon në ofrimin e një shërbimi cilësor të përfaqësimit të klientit.

Gjithashtu, avokatët e ndihmës juridike në Lituanë punojnë me një numër të madh rastesh si pasojë e pagave të ulta. Në këtë mënyrë, duke qenë se koha që i japin secilit rast është e kufizuar, ata mundohen vetëm të sigurojnë minimumin e kriterëve për cilësinë e shërbimit të ndihmës juridike. Promovimi i një sistemi pagese të përshtatshëm mund të inkurajonte specialistët e ndihmës juridike të zgjidhnin si specializim të mëtejshëm, ofrimin e ndihmës juridike për fëmijë.



- **Fonde të përshtatshme** duhet të akordohen si për organizimin ashtu edhe për ofrimin e ndihmës juridike dhe shtetet duhet të sigurojnë dhe ndjekin procesin në mënyrë që një pjesë e mjaftueshme e fondeve t'i dedikohet ndihmës juridike për fëmijë
- **Një sistem page i drejtë** dhe proporcional për ofruesit e ndihmës juridike duhet të vendoset
- **Financimi i ndihmës** juridike duhet të jetë në përputhje me kohën dhe përpjekjen e dedikuar për çdo çështje. Paga për ofruesit e ndihmës juridike duhet të jetë në linjë me objektivin për t'i dedikuar kohën e nevojshme për përfaqësimin e duhur të fëmijës
- **Financimi i ndihmës** juridike duhet të jetë i mjaftueshëm për të financuar ndihmë juridike për të gjithë fëmijët në konflikt me ligjin, pa nevojën e vlerësimit të burimeve të fëmijës apo prindit të tij/saj.
- **Paga për ndihmën juridike ndaj fëmijëve duhet të jetë më e lartë** se ajo e ndihmës juridike për të rritur (përfshijtur personat vulnerabël), duke marrë në konsideratë njohuritë e veçanta dhe aftësitë e nevojshme për të punuar me fëmijët.

3. Ndhmë juridike falas dhe e pakushtëzuar për çdo fëmijë në konflikt me ligjin

● STANDARTET E BE-SË DHE NDËRKOMBËTARE

Një numër në rritje i standarteve ndërkombëtare kërkon që të gjithë fëmijët në konflikt me ligjin të përfitojnë nga ndihma juridike falas, duke i përjashtuar ata nga vlerësimet e burimeve. Duke u nisur nga kjo, Komiteti i KB i të Drejtave të Fëmijëve rekomandon që "Shtetet të ofrojnë përfaqësim ligjor efektiv, falas, për të gjithë fëmijët të cilët përballen me akuza penale". (KDF/C/GC/24, §51)

● PËRFITIMET DHE SFIDAT

Sigurimi i ndihmës juridike tërësisht falas për të gjithë fëmijët, pavarësisht situatës së tyre financiare apo të prindërve të tyre, si dhe ashpërsisë së veprës penale për të cilën ata dyshohen apo dënohen, mund të:

- Inkurajojë përfaqësimin efektiv të të gjithë fëmijëve në konflikt me ligjin dhe të garantojë që asnjë fëmijë nuk i mohohet e drejta për tu ndihmuar ligjërisht si pasojë e arsyeve financiare;
- Parandalojë situata ku ka konflikt interes, si për shembull kur avokatët janë të ndikuar në një masë të caktuar nga prindërit, të cilët e paguajnë atë;
- Lehtësojnë ndikimin negativ të procedimeve penale tek fëmijët. Edhe në rastin e shkeljeve të lehta, kontakti me institucionet e drejtësisë penale mund të jetë i dëmshëm për fëmijën, veçanërisht kur nuk ka mbështetjen e një avokati. Kur bëhet fjalë për fëmijë, nuk ka asnjë çështje të "lehtë" që të justifikojë mospasjen e një avokati.



- Vlerësimet e burimeve nuk duhet të aplikohen dhe vlerësimet e meritave duhet të shihen gjithmonë si të përmbushura kur një fëmijë është në konflikt me ligjin. Ndhmë juridike falas duhet tu mundësohet të gjithë fëmijëve pavarësisht shkeljes për të cilën janë të dyshuar, akuzuar apo dënuar, dhe pavarësisht situatës financiare të fëmijës apo prindërve të tij/saj.
- Ndhmë juridike falas nuk duhet të kushtëzohet nga kombësia apo statusi i rezidencës dhe duhet të jetë e aksesueshme për të gjithë fëmijët brenda juridiksionit të shtetit.



- Në **Belgjikë**, të gjithë fëmijët kanë të drejtën e ndihmës juridike falas. Ata përfitojnë nga prezumimi i pakundërshtueshëm si shtresë në nevojë, e cila i përjashton ata nga vlerësimi i burimeve. Ndërkohë, duke qënë se të gjithë fëmijët kanë të drejtën e ndihmës juridike, vlerësimi i meritës nuk është i nevojshëm.
- Në **Lituani**, fëmijët në konflikt me ligjin kanë të drejtën e ndihmës juridike detyësore pavarësisht aseteve apo të ardhurave të tyre.

4. Përfaqësimi i fëmijëve përgjatë gjithë fazave të procedimeve ligjore

• STANDARTET E BE-SË DHE NDËRKOMBËTARE

Shumë instrumente Europiane dhe ndërkombëtare i referohen detyrimit të përfaqësimit ligjor për fëmijët në konflikt me ligjin.

Direktiva 2016/800 e BE thekson në nenin 6, detyrimin e asistencës nga një avokat: “Shtetet anëtare duhet të sigurojnë që fëmijët të ndihmohen nga një avokat pa vonesa të panevojshme menjëherë sapo ata janë informuar se janë persona të dyshuar apo të akuzuar”. Është e specifikuar se kjo e drejtë zbatohet sa më herët të jetë e mundur në procedurë dhe detajohen pikat kyçe në të cilat kërkohet ndihma juridike. Kjo është në përputhje me gjykimin e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në *Salduz v. Turkey* (2008), ku thuhet se “i akuzuari mund të përftojë nga asistenca e një avokati që në momentin e parë të marrjes në pyetje nga policia”.

• PËRFITIMET DHE SFIDAT

Ngjarje apo vendime të rëndësishme që mund të kenë një ndikim thelbësor dhe të gjatë tek fëmija dhe tek respektimi i të drejtës së tij/saj mund të ndodhin që në fillim të procedimeve penale. Në këtë mënyrë, është e nevojshme që fëmija të ndihmohet që në hapat e parë.

Prania e avokatit që nga fillimi dhe në çdo etapë të procedurës siguron se fëmija është duke u këshilluar ligjërisht, që po informohet mbi të drejtat e tij/saj dhe se respektimi i të drejtave procedurale të tij/saj është duke u monitoruar.

Sigurimi i një avokati që nga hapat e parë dhe pa vonesë është një sfidë më vete. Disa hapa proceduriale, siç është marrja në pyetje urgjente në polici, mund të organizohen në moment të fundit dhe jashtë orareve zyrtare. Kjo mund të kërkojë angazhimin e avokatëve jashtë orarit të punës dhe aplikimin e teknologjive dixhitale (p.sh sisteme të ndihmës juridike elektronike) për të organizuar punën e tyre.



- Ligjet mbi procedurën penale duhet të përcaktojnë qartazi se një fëmijë në konflikt me ligjin ka të drejtën të ndihmohet nga një avokat që nga fillimi e në çdo hap të procedurës.
- Të gjithë aktorët e përfshirë në procedime duhet të jenë të detyruar të respektojnë të drejtën e fëmijës për të patur avokat që në fazat fillestare. Atyre iu kërkohet të ndihmojnë fëmijën të kontaktojë dhe të presë avokatin që në fazën më të hershme të mundshme, sidomos në momentin e marrjes në pyetje nga policia.
- Duhet të krijohet një listë me **avokatë në detyrë** dhe tu mundësohet të gjithë profesionistëve të drejtësisë. Është gjithashtu e këshillueshme për të zhvilluar një regjistër dixhital që mundëson gjetjen dhe komunikimin e menjëhershëm me një avokat.
- Ligji vendas duhet të zbatohet saktë **Direktivën 2016/800 të BE** në lidhje me pjesëmarrjen e një avokati në çto etapë të procedurës dhe të garantojë se sistemi i ndihmës juridike ofron pagesën e përshtatshme për ofruesin e ndihmës juridike.



- * Në **Francë**, prania e një avokati është e detyrueshme përgjatë të gjithë procedurës në të cilën fëmija është në procedim penal, si dhe kur fëmija ndalohet nga policia, edhe nëse ai/ajo nuk është ende nën ndjekje penale.
- * Në **Shqipëri**, ligji thekson qartazi se fëmijët në konflikt me ligjin duhet të ndihmohen gjithmonë nga një avokat. Kjo zbatohet që nga momenti i parë në kontakt me policinë, përpara marrjes në pyetje e deri në fazën e dënimit duke e bërë kështu praninë e avokatit të detyrueshëm përgjatë të gjithë procedimit.

5. Akses efektiv në ndihmën juridike për fëmijët e privuar nga liria

● STANDARTET E BE-SË DHE NDËRKOMBËTARE

Standartet e BE dhe ato ndërkombëtare përcaktojnë të drejta procedurale specifike për fëmijët në lidhje me heqjen e lirisë. Kjo përfshin kufizimin e përdorimit të privimit nga liria si një masë e fundit dhe për një kohëzgjatje sa më të shkurtër, me nevojën për të rishikuar vendimin periodikisht. Neni 10 i Direktivës 2016/800 së BE në veçanti, i parashikon këto kushte. Kjo Direktivë, në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijës, përcakton trajtimin specifik për tu ndjekur në rastet e privimit nga liria (Neni 12) dhe rekomanton që Shtetet Anëtare të fokusohen fillimisht tek dënimet alternative (Neni 11).

Akresi i menjëhershëm në ndihmën juridike është gjithashtu një e drejtë themelore e fëmijës kur atij/asaj i është privuar liria dhe përcaktohet në Nenin 37 të Konventës Europiane të të Drejtave të Fëmijës dhe ofrohet gjithashtu në standarte të tjera ndërkombëtare. Komiteti i KB mbi Drejtat e Fëmijës specifikon se: “nuk duhet të ketë asnjë pengesë në mundësinë e fëmijës për të komunikuar në konfidencialitet dhe në çdo kohë me avokatin e tij/saj apo asistentët të tjerë”. (CRC/C/GC/24, §95, e).

● PËRFITIMET DHE SFIDAT

Fëmijët në konflikt me ligjin mund të privohen nga liria në stade të ndryshme të procedimit dhe në kontekste të ndryshme, përfshirë arrestimin apo ndalimin nga policia, paraburgim apo burgim pas dhënies së dënimit.

Sigurimi i aksesit të duhur në ndihmë juridike për këta fëmijë është veçanërisht i rëndësishëm pasi mbron respektimin e të drejtave të tyre themelore gjatë ndalimit, por ndihmon gjithashtu në mbrojtjen e tyre ndaj dhunës (përfshirë torturën apo trajtime të tjera degraduese dhe çnjerëzore), ndihmon në aksesin për edukim apo për të mbajtur kontakt me familjarët. Ai është gjithashtu thelbësor pasi vazhdimisht do të ndiqen faza të rëndësishme të procedurës, si dhe do të merren vendime lidhur me fëmijën dhe çka kërkon që fëmija të jetë i aftë të përgatisë mbrojtjen e tij/saj së bashku me përfaqësuesin.

Sidoqoftë, privimi i lirisë ka efektin e izolimit të fëmijës dhe kjo mund të jetë një pengesë e konsiderueshme, në aksesin e fëmijës në ndihmën juridike. Refuzimi apo mungesa e bashkëpunimit të institucionit ku fëmija është i ndaluar mund të jetë një pengesë e madhe. Për shembull, aksesin e fëmijës në ndihmë juridike mund të kufizohet nga aksesin e dobët për një telefon apo mjete të tjera të komunikimit për të kontaktuar përfaqësuesit e tij/saj ligjor. Në anën tjetër, sigurimi i konfidencialitetit të shkëmbimeve që ndodhin përmes telefonit apo në takime ballë për ballë mund të mos jetë i mundur si pasojë e rregullave institucionale, praktikave të staftit apo mungesës së hapësirave të përshtatshme.

Për më tepër, gatishmëria e një avokati apo mungesa e tij mund të bëhen akoma më problematike kur fëmija është i privuar nga liria.

Të vizitosh fëmijën në institucion është veçanërisht e rëndësishme për tu përgatitur për fazën tjetër të procedurës; për të siguruar se të drejtat e tij/saj po respektohen; për të ndërtuar dhe ruajtur besimin mes klientit të tij fëmijë dhe avokatis; si dhe për të siguruar se avokati është në dijeni të realitetit të masave të dënimit dhe të ndikimit që ato kanë tek klienti fëmijë, në mënyrë që ta përfaqësojë atë në formën më të mirë të mundshme. Sidoqoftë, një vizitë e tillë shpesh është konsumuese në kohë për avokatin dhe pak prej tyre shpenzojnë kohë për ta bërë këtë.



- Ligjet dhe rregulloret në lidhje me fëmijët e privuar nga liria duhet të sigurojnë të drejtën e tyre për akses efektiv në ndihmë juridike dhe të ofrojnë masa pozitive si telefonata të vazhdueshme me avokatin dhe infrastrukturë të posaçme për të siguruar konfidencialitet gjatë takimeve apo telefonatave.
- Ligjet dhe rregulloret në lidhje me ndihmën juridike duhet të mbulojnë specifikat e aksesit në ndihmë kur një fëmijë është i privuar nga liria. Tarifat e avokatëve për ndihmë juridike duhet të përshtaten me këtë situatë dhe të jenë mjaftueshëm motivuese për ta që të shkojnë në institucionet e paraburgimit/burgimit për të takuar klientët e tyre fëmijë.
- Mekanizmat Kombëtare të Parandalimit (krijuar nga OPCAT) dhe institucione të tjera përgjegjëse për monitorimin e institucioneve të vuajtjes së dënimit duhet të përfshijnë në monitorimin e tyre, aksesin efektiv në ndihmë juridike për të miturit⁴.



- * Në **Belgjikë**, "Shërbimet Juridike për të rinjtë", janë shërbime të financuara nga shteti që specializohen në ndihmë juridike dhe sociale si dhe asistencë për personat nën 22 vjeç. Një nga këto shërbime ofron konsultime të linjës së parë të ndihmës juridike për fëmijë në disa institucione të vuajtjes së dënimit.



I Publikuar në 2019, raporti final i **Studimit Global mbi Fëmijët e Privuar nga Liria** i Kombeve të Bashkuara prezanton një vështrim gjithëpërfshirës të dënimit me heqje lirie për fëmijët në mbarë botën dhe thekson rekomandimet për një respektim më të mirë të të drejtave të tyre: <https://omnibook.com/Global-Study-2019>

⁴ Informacion i detajuar mund të gjendet në faqet 97 – 98 të DCI-Belgium Guide Praktike mbi monitorimin e vendeve ku fëmijët janë të privuar nga liria : http://www.childrensrightsbehindbars.eu/images/Guide/Practical_Guide.pdf

6. Kufizim dhe kontroll strikt mbi refuzimin e ndihmës juridike

● STANDARTET E BE-SË DHE NDËRKOMBËTARE

Direktiva e BE dhe standartet ndërkombëtare sigurojnë kufizime strikte për mundësinë që ka një fëmijë për të refuzuar të drejtën e tij/saj për tu përfaqësuar. Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës përcakton si parim që fëmijët nuk duhen lejuar ta refuzojnë këtë të drejtë, por lejon një përjashtim kur vendimi “merret vullnetarisht dhe nën supervizion gjyqësor të paanshëm”. (CRC/C/GC/24, §51). Për më tepër, Direktiva 2013/8 e BE shton se, në këtë rast, fëmijëve iu duhet mundësuar “informacion i përshatshëm për të kuptuar pasojat e refuzimit të kësaj të drejte”.

● PËRFITIMET DHE SFIDAT

Nëse refuzimi është i kufizuar, por ende i mundshëm, mund të jetë e vështirë të sigurohemi se ai bëhet nga fëmija, pasi ka kuptuar plotësisht pasojat. Gjithashtu, edhe pse kjo masë mund të kufizojë numrin e fëmijëve që refuzojnë të drejtën e tyre për përfaqësim, nuk e përjashton plotësisht atë, çka nënkupton që të drejtat e këtyre pak fëmijëve të rrezikohen në masë të madhe si pasojë e mos përfaqësimit.

Ndalimi apo kufizimi i mundësisë së refuzimit të së drejtës së fëmijës për tu ndihmuar nga një avokat siguron se atij/asaj nuk po i mohohet e drejta themelore për arsyet e gabuara, siç është keqinformimi apo keqkuptimi i pasojave që do kishte refuzimi i kësaj të drejte.

Qëllimi kryesor është ndalimi nga refuzimi i të drejtës si pasojë e presionit apo inkurajimit për ta bërë këtë nga familjarë apo autoritete që udhëheqin këtë procedurë. Gjithashtu parandalohet refuzimi i kësaj të drejte si pasojë e mosinformimit të duhur mbi të gjithë elementet që rrezikohen (p.sh sepse ata nuk kuptojnë rolin e avokatit, sepse besojnë se do të jetë një kosto e lartë dhe e papërballueshme për familjen e tyre, apo sepse nuk besojnë se veprat për të cilat ata dyshohen apo akuzohen nuk janë serioze (apo kriminale) dhe për rrjedhojë nuk i përceptojnë dot pasojat që procedurat mund të kenë).



- ➔ Ligji duhet ta ndalojë fëmijën nga refuzimi i të drejtës për ndihmë juridike. Në rastet kur marrëdhënia mes avokatit dhe fëmijës klient nuk është në harmoni, ligji duhet të inkurajojë fëmijën të ndërrojë avokat përmes një procedure të thjeshtë.
- ➔ Nëse refuzimi është i lejuar, por i kufizuar (p.sh nëse fëmija lejohet të refuzojë të drejtën e të paturit një avokat dhe e bën këtë vullnetarisht dhe pasi është informuar për pasojat), **masa mbrojtëse shtesë** duhet të vendosen. Për shembull, mund të bëhet kontrolli gjyqësor i një vendimi të tillë ose opsioni që profesionistët e tjerë të përfshirë (p.sh prokurorët) të ndalojnë refuzimin.



- * Në **Belgjikë**, Kodi i Procedurës Penale specifikon se fëmijët mund të mos e refuzojnë të drejtën e tyre për tu ndihmuar nga një avokat
- * Në **Lituani**, Kodi i Procedimeve Penale ka vendosur që oficerët e policisë gjyqësore, prokurorët dhe gjykatat nuk janë të detyruar të pranojnë refuzimin e një avokati nga i mituri.

7. Avokatë të specializuar për fëmijë

● STANDARTET E BE-SË DHE NDËRKOMBËTARE

Shumë standarte ndërkombëtare i referohen specializimit të avokatëve kur punojnë me fëmijët në konflikt me ligjin. Synohet të krijohet një kategori profesionistësh të dedikuar që njihen në nivel kombëtar. Në veçanti, Udhëzuesi i KE mbi drejtësinë miqësore për fëmijë rekomandon krijimin e një “sistemi avokatësh të specializuar për fëmijë”. (§104).

● PËRFITIMET DHE SFIDAT

Profesionistët që punojnë me fëmijët duhet të kenë njohuri dhe të kuptuar të mjaftueshëm për aspektet e ndryshme ligjore të procesit të drejtësisë për të mitur dhe duhet të jenë të trajnuar për të punuar me fëmijët në konflikt me ligjin. Sot, në vendet Europiane, fëmijët në konflikt me ligjin kanë të drejtën e ndihmës juridike dhe kjo ndihmë (kur është detyësore) mund të ofrohet vetëm nga avokatët. Sidoqoftë, specializimi i “avokatëve për të mitur” nuk ekziston në të gjitha vendet.

Specializimi i avokatëve do të përmirësonte rrënjësisht aftësinë e profesionistëve

ligjorë për të përfaqësuar fëmijën, për të mbrojtur interesat më të larta të tij/saj, për të komunikuar me të dhe për të ofruar ndihmë juridike cilësore dhe me fokus te fëmija.

Rrjedhimisht, termi “avokat për të mitur” do të bënte çdo avokat që përfaqëson fëmijët lehtësisht më të njohur dhe do të paraqiste një nivel të caktuar kompetence për përfaqësimin e fëmijës. Në fakt, “avokatët për të mitur” të specializuar, do të kishin aftësitë dhe njohuritë ligjore të nevojshme gjatë punës me fëmijët në konflikt me ligjin. Të paturit e një grupi me “avokatë për të mitur” do të ndihmonte gjithashtu fëmijët dhe prindërit e tyre për të zgjedhur një avokat.

Sigurimi i specializimit të avokatëve në një rajon pak të populluar, ku vetëm pak avokatë punojnë dhe ku rastet që përfshijnë fëmijë në konflikt me ligjin janë të pakta, mund të jetë sfidues. Për këtë arsye, një avokat duhet të lejohet të ketë disa specializime.



- Në të gjitha vendet e BE, rregulloret ligjore duhet të mundësojnë **krijimin e kategorisë së “avokatëve për të mitur”**. Këta profesionistë do të jenë të specializuar për të ofruar ndihmë juridike për fëmijët. Ata do të ndjekin gjithashtu trajnime vazhduese dhe të detyrueshme mbi çështje që lidhen me fëmijët.
- **Duhet të krijohet një listë me “avokatë për të mitur”** dhe të jetë e aksesueshme në çdo Dhomë Avokatie dhe Bord të Ndhmës Juridike



- Shumë akte ligjore në fuqi në Europë kërkojnë specializimin e aktorëve që punojnë me fëmijët në konflikt me ligjin përfshirë avokatë, gjyqtarë, prokurorë, oficerë të Shërbimit të Provës dhe oficerë policie.
- Në disa vende si **Belgjika, Finlanda, Shqipëria dhe Italia**, në mënyrë që të ofrohet ndihmë juridike për fëmijët, një avokat duhet të jetë pjesë e listës “avokatë për të mitur”, psh. të jetë i specializuar në ofrimin e ndihmës juridike për fëmijë. Në rastë të tilla, zyrat e ndihmës juridike kanë një listë të brendshme të ofruesve të ndihmës juridike të specializuar në këtë fushë.
- Në disa prej këtyre vendeve, kjo listë mund të aksesohet lehtë. Dhoma e Avokatëve e Finlandës për shembull, disponon lista të avokatëve dhe fushat e ekspertizës së tyre. Një aplikant mund të kontaktojë Dhomën e Avokatisë Finlandeze ose të përdorë shërbimin e dedikuar online për të identifikuar një avokat të specializuar për të drejtat e fëmijëve.

8. Trajnimi i detyrueshëm fillestar dhe vazhdues për avokatët e të miturve

● STANDARTET E BE-SË DHE NDËRKOMBËTARE

Shumë standarte të BE-së dhe të KB përmendin nevojën absolute që ofruesit e ndihmës juridike të ndjekin trajnime specifike, si fillestare, edhe vazhduese, në mënyrë që të mund të asistojnë fëmijët. Standartet ndërkombëtare përmendin ndër të tjera se trajnimi duhet të jetë multidisiplinar dhe të mundësojë që profesionistët të fitojnë njohuri dhe aftësi praktike në lidhje me të drejtat e fëmijëve, komunikimin me fëmijët, përshtatjen e procedurave për fëmijët, psikologjinë dhe zhvillimin e fëmijës.

Për shembull, Udhëzimet dhe Parimet e Kombeve të Bashkuara mbi aksesin në ndihmë juridike në sistemet e drejtësisë penale, shprehen se ofruesit e ndihmës juridike që përfaqësojnë fëmijët duhet të marrin “trajnim bazë ndërdisiplinor për të drejtat dhe nevojat e fëmijëve” por gjithashtu “trajnim vazhdues dhe të thelluar dhe të jenë të aftë të komunikojnë me fëmijët në nivelin e tyre të të kuptuarit”. (Udhëzimi11, §58 d)

● PËRFITIMET DHE SFIDAT

Trajnim fillestar i specializuar është i detyrueshëm në vendet ku ekziston kategoria e “avokatit për të mitur”. Sidoqoftë, këto trajnime (fillestare apo vazhduese) për avokatët që ofrojnë ndihmë juridike për fëmijë në disa vende (Lituani, çeki, Irlandë, Poloni, Suedi) nuk janë të detyrueshme dhe vetëm trajnimi vullnetar është i mundshëm.

Vetëm trajnimi i specializuar dhe me detyrim, fillestar dhe vazhdues, mund të garantojë se profesionistët do të jenë të mirëinformuar mbi zhvillimin fizik, psikologjik, mendor dhe social të adoleshentëve si dhe mbi nevojat e veçanta të fëmijëve më vulnerabël, si ata në situatë rruge, fëmijëve në emigrim dhe fëmijëve që i përkasin minoriteteve racore, etnike, fetare, gjuhësore apo të tjera.



- **Autoritetet** duhet të sigurojnë trajnim fillestar të specializuar, të përparuar, dhe falas për avokatët në lidhje me ligjin për fëmijët dhe problematikat që lidhen me të miturit.
- Ato duhet të propozojnë gjithashtu **trajnim vazhdues të specializuar me orientim teorik** dhe praktik që mbulon pyetje në lidhje me fëmijët.
- Trajnimi fillestar dhe ai vazhdues duhet të përshtasin një qasje **multidisiplinare**. Puna me fëmijët kërkon aftësi specifike nga fusha të ndryshme si psikologjia, sociologjia dhe kriminologjia. Avokatët e të miturve duhet të mësojnë: si të punojnë me fëmijët, si t'i kuptojnë ata dhe situatën e tyre, si të jenë empatikë dhe të durueshëm, si të dëgjojnë në mënyrë aktive etj



- Në **Belgjikë**, trajnimi fillestar dhe ai vazhdues janë të detyrueshëm. Kjo aplikohet zakonisht tek të gjithë avokatët në përgjithësi, por në veçanti për ata që duan të përfaqësojnë fëmijët. Trajnimi vazhdues mund të marrë forma të ndryshme si: pjesëmarrje në konferenca, debate, seminare, webinarë, trajnime në shkolla, vizita të organizuara në një Institucion Publik për Mbrojtjen e Fëmijëve (qendra të dënimit për fëmijët në konflikt me ligjin), etj. Sesionet janë të organizuara kryesisht nga dhomat e avokatisë.

9. Promovimi i bashkëpunimit midis aktorëve që ndihmojnë dhe mbështesin fëmijët në procedura ligjore

● STANDARTET E BE-SË DHE NDËRKOMBËTARE

Udhëzimet dhe Parimet e **Kombeve të Bashkuara mbi aksesin në ndihmën juridike në sistemet e drejtësisë penale** rekomandon që Shtetet duhet të krijojnë mekanizma që “sigurojnë bashkëpunim të ngushtë dhe sisteme referimi të përshtatshme ndërmjet ofruesve të ndihmës juridike dhe profesionistëve të ndryshëm për të përfutur një të kuptuar gjithëpërfshirës të fëmijës, si dhe një vlerësim të situatës dhe nevojave të tij/saj ligjore, psikologjike, sociale, emocionale, fizike dhe konjitive. (Udhëzimi 11 §58. e)

● PËRFITIMET DHE SFIDAT

Shumica e vendeve europiane propozojnë një sistem të veçantë mbështetjeje për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.

Bashkëpunimi mes profesionistëve nga fusha të tjera mund të ndihmojë në ndërtimin e një sistemi ndihme juridike të ndjeshme ndaj fëmijëve, i cili thekson nevojat e veçanta të çdo fëmije dhe siguron se ndihma që jepet është përshtatur në përputhje me këto nevoja.

Në shumicën e vendeve, ndihma psikologjike ofrohet si një mbështetje për fëmijën. Për më tepër, institucionet e mbrojtjes së fëmijëve ftohen të marrin pjesë në procedime si organ që monitoron mbrojtjen e duhur të interesave dhe të të drejtave të fëmijës.

Edhe pse institucione të specializuara janë të përfshira në procesin ligjor, funksioni i tyre mbetet formal dhe ka mungesë të pjesëmarrjes aktive. Gjithashtu, specialistët nuk janë gjithmonë disponibël për të marrë pjesë në çdo procedim. Bashkëpunimi mes profesionistëve mund të kufizohet ndonjëherë nga vendimi i gjykatësit, pasi ata jo gjithmonë e pranojnë atë.



- Duhet të mbështeten 2 lloje bashkëpunimesh:
 - Me organizata që ofrojnë masa alternative në mënyrë që avokati të mund t'i sugjerojë gjykatësit masa më të përshtatshme në lidhje me situatën e fëmijës;
 - Me shërbimet sociale, nëse fëmija ka nevoja të veçanta, në mënyrë që avokati mund të drejtojë fëmijën tek shërbimet e specializuara.
- **Duhet të ndërtohet bashkëpunim ndërinstytucional i koordinuar**, i sistematizuar dhe i balancuar.
- Trajnime të përbashkëta dhe workshop-e të orientura drejt praktikës me fokus **bashkëpunimin** dhe **menaxhimin e përbashkët** të çështjeve mund të organizohen në mënyrë që të inkurajohet bashkëpunimi.

10. E drejta për përkthim

● STANDARTET E BE-SË DHE NDËRKOMBËTARE

E drejta për asistencën e një përkthyesi, nëse personi i akuzuar nuk flet gjuhën që përdoret në gjykatë, është një nga elementet themelore e të drejtës për një gjyq të drejtë (neni 6, §3 e) GJEDNJ). Sipas vendimit të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, asistenca e një përkthyesi duhet të sigurohet që në fazën e hetimit (Baytar v. Turkey). Kjo ndihmë duhet të jetë falas, pavarësisht burimeve financiare të personit të akuzuar. Për më tepër, Gjykata specifikon se ky detyrim shtetëror përfshin deri në një farë mase, kontrollin e cilësisë së përkthimit.

Direktiva 2010/64 e BE parashikon se “personave të dyshuar apo akuzuar të cilët nuk flasin apo kuptojnë gjuhën e procedimit penal iu mundësohet pa asnjë vonesë përkthimi gjatë procedimit kur vihen përballë autoriteteve hetuese apo gjyqsore përfshirë këtu marrjen në pyetje nga policia, të gjitha dëgjuesat në gjyq dhe çdo dëgjese të nevojshme ndërmjet tyre”. Paragrafi 2 specifikon se “përkthimi duhet të jetë i mundshëm për komunikimin mes personave të dyshuar apo akuzuar dhe këshillëtarit të tyre ligjor (...)” (neni 2).

● PËRFITIMET DHE SFIDAT

Kur një fëmijë nuk kupton apo ka njohuri të pakët të gjuhës së procedimeve, është thelbësore që një përkthyes të jetë i pranishëm që nga fillimi dhe në çdo fazë të

procedimit. Përkthyesi luan një rol vendimtar në efektivitetin e të drejtës së fëmijës për ndihmë juridike duke qenë se ai/ajo do të mundësojë komunikimin midis fëmijës dhe avokatit të tij/saj. Sidoqoftë, ndeshen pengesa të mëdha siç është ulja e numrit të përkthyesve në disa rajone. Po ashtu, disa avokatë theksojnë mungesën e trajnimit të duhur të përkthyesve për të komunikuar në një formë miqësore për fëmijët.



- Ofrim trajnimi falas për përkthyesit mbi komunikimin me fëmijët dhe të drejtat e fëmijëve;
- Monitorimi dhe kontrolli i cilësisë së punës së përkthyesve që punojnë me fëmijët;
- Sigurimi i një numri të përshtatshëm të përkthyesve në të gjitha rajonet (edhe zonat rurale);
- Garantimi i të drejtës së fëmijëve për të patur asistencë falas nga një përkthyes që nga fillimi dhe në çdo fazë të procedimit, përfshirë këtu dhe takimin me avokatin e tij/saj.

11. Konfidencialiteti dhe privatësia e komunikimit midis fëmijës dhe ofruesit të ndihmës juridike

● STANDARTET E BE-SË DHE NDËRKOMBËTARE

Direktiva 2016/800 e BE rikujton detyrimin e Shteteve për të siguruar të drejtën e fëmijëve për tu takuar privatisht dhe për të komunikuar me avokatin përfaqësues gjatë të gjitha fazave kyçe të procedimit. Direktiva thekson se konfidencialiteti i çdo forme komunikimi që mund të ndodhë mes fëmijës dhe avokatit të tij/saj si në takime, korrespondencë, biseda telefonike etj, duhet të respektohet në mënyrën e përshtatshme. (Neni 6. 4. a &b)

● PËRFITIMET DHE SFIDAT

Privatësia dhe konfidencialiteti midis fëmijës dhe ofruesit të ndihmës juridike (avokatit) duhet të jetë e mbuluar në të gjitha nivelet e procedimeve juridike ose jo dhe në ndërhyrje të tjera, si dhe kjo mbrojtje duhet të garantohet nga ligji.

Sidoqoftë, hapësirat ku ndodh komunikimi me fëmijët nuk janë gjithmonë mjaftueshëm të përshtatura. Për shembull, ato nuk janë gjithmonë të izoluar akustikisht.



Autoritetet duhet të sigurojnë një mjedis që garanton konfidencialitetin e komunikimit midis avokatit mbrojtës dhe fëmijës.

Shembull:

- Avokati dhe fëmija klient i tij/saj mund të takohen në një dhomë të përshtashme dhe të izoluar akustikisht (në një gjykatë, stacion policie, qëndër të vuajtjes së dënimit etj.)
- Kur fëmija është i privuar nga liria, ai/ajo mund të flasë lirshëm në telefon pa patur frikën e të qenit i dëgjuar nga të tjerët.



- Në **Lituani**, për të siguruar konfidencialitetin e përkthimit (kur përkthimi është i nevojshëm) Kodi i Procedurës Penale ndalon marrjen në pyetje të përkthyesit si një dëshmitar të rrethanave, për të cilat ai ka dijeni gjatë përkthimit mes të dyshuarit dhe avokatit.
- Në disa gjykata për të mitur në **Belgjikë**, në dispozicion të avokatëve vihet një dhomë, të cilën ata mund ta përdorin kur kanë nevojë të bisedojnë me klientin e tyre të mitur. Kjo siguron konfidencialitetin e komunikimit të tyre, ndërkohë që në disa gjykata të tjera në vend bisedat kryhen në korridore të Gjykatës, ku konfidencialiteti nuk mund të garantohet aspak.

12. Zgjedhja e lirë e avokatit

• STANDARTET E BE-SË DHE NDËRKOMBËTARE

Standartet ndërkombëtare dhe ato të BE sigurojnë zgjedhjen e lirë të avokatit, duke filluar me Konventën Ndërkombëtare të të Drejtave Civile dhe Politike, e cila i referohet të drejtës që ka çdo i akuzuar për asistencën e një avokati të zgjedhur nga vetë ai/ajo. Duhet theksuar sidoqoftë se kjo e drejtë nuk është absolute dhe ka kufizime nën kornizën e ndihmës juridike. Për shembull, Rekomandimi i KE për të drejtën e ndihmës juridike për personat e dyshuar apo akuzuar në procedime penale thekson se “preferencat dhe dëshirat e personave të dyshuar apo akuzuar dhe të personave të zgjedhur duhet të merren në konsideratë sa më shumë të jetë e mundur nga sistemi kombëtar i ndihmës juridike në lidhje me zgjedhjen e avokatit të ndihmës juridike. (2013/C 378/03, §13).

● PËRFITIMET DHE SFIDAT

Të paturit e të drejtës së zgjedhjes së një avokati ndihmon në ndërtimin e një marrëdhënieje bazuar në besim dhe komunikim pozitiv mes fëmijës dhe avokatit të tij/saj, duke lejuar kështu ndihmën juridike të funksionojë më së miri.

Avokatët që janë më të kualifikuar në përfaqësimin e fëmijëve (p.sh avokatë që kanë arritur kompetenca shtesë gjatë trajnimeve apo studimeve dhe/ose përvojave të përfaqësimit të fëmijëve etj) mund të zgjidhen më shpesh.

Edhe kur një fëmijë në konflikt me ligjin është i aftë për të zgjedhur një avokat, prindërit ose përfaqësuesit ligjore mund të jenë shumë ndihmues. Për më tepër, nëse prindërit zgjedhin ose ndihmojnë në zgjedhjen e një avokati për fëmijën, avokati duhet të jetë i vetëdijshëm se ai/ajo përfaqëson fëmijën dhe jo prindërit. Ky parim mund të jetë më i vështirë për tu zbatuar në vendet ku është gjykatësi, ai që përcakton avokatët.



- ➔ Ligje dhe rregullore në lidhje me ndihmën juridike duhet të përqafojnë parimin e **zgjedhjes së lirë të avokatit** dhe të organizojnë zbatimin e tij.
- ➔ Për të mundësuar informimin mbi zgjedhjen e avokatit, duhet të krijohet dhe të jetë disponibël një **listë me avokatë të ndihmës juridike** duke specifikuar nëse ata ofrojnë ndihmë të specializuar për fëmijët.
- ➔ Respektimi i zgjedhjes së lirë të avokatit kërkon që fëmija të ketë gjithashtu të drejtën për të ndryshuar avokat në kontekstin e ndihmës juridike, atëherë kur është e nevojshme.



- ➔ Në disa vende europiane, e drejta për të zgjedhur lirisht avokatin është e garantuar me ligj. Në këto vende, ekziston mundësia e zgjedhjes së lirë të një avokati që më pas përcaktohet për të ndërhyrë nën kornizën e ndihmës juridike (ky avokat është dakord që të ndërhyjë si një ofruer i ndihmës juridike). Ky rast është i pranishëm të paktën në Finlandë, Francë, Gjermani, Itali, Lituani, Suedi, Shqipëri dhe Belgjikë. Në Itali për shembull, fëmijët në konflikt me ligjin mund të zgjedhin një avokat nga lista e avokatëve që kanë pranuar të ndërhyjnë nën kornizën e ndihmës juridike.

13. Mundësia e ndërrimit të avokatit

● STANDARTET E BE-SË DHE NDËRKOMBËTARE

Udhëzuesi i UNICEF mbi Ndihmën Juridike për Fëmijë thekson se “nëse marrëdhënia me fëmijën bëhet disfunktionale dhe ai/ajo kërkon të ndërrojë avokat, atëherë duhet respektuar e drejta e fëmijës për të zgjedhur avokat duke i shpjeguar gjithashtu çdo vështirësi që mund të vijë si pasojë”. (Udhëzimi 4)

● PËRFITIMET DHE SFIDAT

Nëse fëmija ndihet i përfaqësuar jo mirë, është e rëndësishme që ai/ajo të mund të ndërrojë avokat. Kjo është gjithashtu një çështje e rëndësishme në raport me marrëdhënien: fëmija duhet të ketë besim tek avokati dhe të ndihet i dëgjuar dhe kuptuar. Kjo ka një ndikim të madh në cilësinë e ndihmës juridike.

Fëmijët nuk mund të ndjekin një procedurë të gjatë dhe të vështirë të vetëm dhe mund të mos jenë në dijeni të së drejtës së tyre për të ndërruar avokat. Po ashtu, në disa nga vendet pjesë e studimit, e drejta për të ndërruar avokat nuk është e garantuar në kontekstin e ndihmës juridike. Në fakt, në disa vende, nëse një fëmijë, të cilit i është caktuar një avokat nën kornizën e ndihmës juridike, dëshiron ta ndërrojë atë, ai/ajo mundet ta bëjë këtë, por avokati i ri nuk do të ndërhyjë nën kornizën e ndihmës juridike dhe për rrjedhojë do të kërkojë pagesë.



- Ligjet dhe rregulloret mbi ndihmën juridike duhet të garantojnë të drejtën e fëmijës për të ndryshuar avokat; ky ndryshim nuk duhet të përmbajë kosto për fëmijën apo për familjen e tij/saj dhe duhet të jetë i ofruar nën kornizën e ndihmës juridike.
- Procedura duhet të jetë shumë e thjeshtë, e njohur për fëmijën dhe e mundshme që ai/ajo ta ndjekë vetë atë. Në veçanti, nuk duhet të varet nga avokati i parë. Fëmija duhet gjithashtu **të informohet mbi procedurën** në një formë miqësore për fëmijë.
- Ligjet dhe rregulloret mbi ndihmën juridike duhet gjithashtu **të shmangin lejimin e shumë ndryshimeve** të avokatëve; parimi i vazhdimësisë në ndihmën juridike mbetet i rëndësishëm



- ✳ Në vendet e marra në studim, ndërrimi i avokatit është shpesh i mundshëm nëse “thyeret besimi” apo ka “mosdakordësi” mes fëmijës dhe avokatit ose në rastet kur avokati dështon. Megjithatë përbëjnë hapin e parë të rëndësishëm, këto masa juridike apo rregullore nuk janë të mjaftueshme. Në Belgjikë, projekti Avokati im, të drejtat e mia theksoi këtë fakt se, megjithatë ndërrimi i avokatëve nuk është në thelb i ndërlikuar, është ende e vështirë që të rinjtë ta marrin këtë nismë. Në të vërtetë, të miturit në përgjithësi nuk dinë kë të telefonojnë apo cilën procedurë të ndjekin.

14. Fëmijët në nevojë për ndihmë të specializuar në fusha të ndryshme të ndihmës juridike

Fëmijët në konflikt me ligjin, për shkak të situatës së tyre të veçantë, mund të kenë nevojë për asistencë juridike në disa fusha të ligjit. Për shembull, ky mund të jetë rasti i fëmijëve emigrantë që janë gjithashtu në konflikt me ligjin.

● STANDARTET E BE-SË DHE NDËRKOMBËTARE

Udhëzimet dhe Parimet e Kombeve të Bashkuara të 2012 mbi ndihmën juridike në sistemet e drejtësisë penale sigurojnë parimin e barazisë (parimi 10): “Duhet të merren masa të veçanta për të siguruar akses të plotë për gratë, fëmijët dhe grupet me nevoja të veçanta duke përfshirë këtu minoritetet, popujt indigjenë, personat pa shtetësi, azilkërkuesit, shtetasit e huaj, emigrantët, refugjatët dhe persona të shpërngulur brenda vendit. Këto masa duhet të adresojnë nevojat e veçanta të këtyre grupeve, përfshirë dhe marrjen në konsideratë të gjinisë dhe moshës”. (§32).

Udhëzuesi i Këshillit të Europës mbi drejtësinë miqësore për fëmijët përmend se “Mbrotjtje dhe ndihmë e veçantë duhet të garantohet për fëmijët më vulnerabël si fëmijët emigrantë, refugjatë dhe azilkërkues, fëmijët e pashoqëruar (...)” (III, D, 2).

Udhëzuesi thekson gjithashtu në Memorandumin Shpjegues nevojën për trajnime mbi këto çështje, i cili specifikon se “të drejtat e fëmijëve mund dhe duhet të jenë pjesë e kurrikulës mësimore në shkolla dhe në fusha të veçanta të edukimit të lartë (ligj, psikologji, etj.) Kjo duhet të mbulojë specifikat e të drejtave të fëmijëve, si dhe legjislacionin përkatës si ligjin e familjes, drejtësia për të mitur, ligji i emigrimit dhe azilit etj. Shtetet Anëtare inkurajohen që të organizojnë kurse specifike trajnimi”. (§68).

● PËRFITIMET DHE SFIDAT

Kur një fëmijë është në konflikt me ligjin dhe i është përcaktuar një avokat për këtë qëllim, avokati mund t'i vijë në ndihmë fëmijës për asistencë juridike apo nevoja në fusha të tjera. Një fëmijë i përfshirë në disa procedime do të ketë takime me një numër të madh aktorësh të ndryshëm, rolin dhe funksionin e të cilëve, fëmija mund të mos e kuptojë plotësisht. Të paturit e një avokati që zotëron të dy apo të gjitha fushat, lejon fëmijën të shoqërohet dhe udhëhiqet në mënyrë të përshtatshme përgjatë procedimeve të ndryshme, duke shmangur kështu shtimin e numrit të avokatëve dhe duke forcuar besimin. Sidoqoftë, lloje të tjera të procedimeve, si procedimet pjesë e ligjit të emigrimit për shembull, janë zakonisht shumë specifike dhe kërkojnë avokatë shumë të specializuar. Në praktikë për shembull, është shumë e rrallë të gesh avokatë të specializuar si në ligjin për emigrimin, por edhe në procedurën penale për fëmijë.



- Autoriteti përgjegjës për caktimin e avokatëve për fëmijët në konflikt me ligjin duhet të vlerësojë nëse fëmija ka nevojë për një avokat me disa specializime.
- Nëse autoriteti përgjegjës zbulon se fëmija në konflikt me ligjin ka nevojë për ndihmë nga më shumë se një fushë specializimi, duhet të vendoset prioritet caktimi i një avokati të specializuar në secilën nga këto fusha dhe nëse kjo nuk është e mundur, duhet caktuar më shumë se një avokat.



- ✳ Në Hollandë, ndihma juridike për azilkërkuesit ofrohet nga avokatë që janë pjesë e Dhomës së Avokatisë Hollandeze dhe të regjistruar në Bordin e Ndhmës Juridike. Ata duhet të përmbushin një sërë kërkesash përfshirë kryerjen e kurseve të specializimit, të jenë anëtarë të Grupit të Punës për Ndhmë Juridike ndaj Refugjatëve pjesë e Këshillit Hollandez për Refugjatët dhe plotësojnë standartet e Guidës së Praktikave më të mira mbi Ligjin e Azilit. Për të shtrirë aktivitetin e tyre në fushën e azilit, avokatët duhet të ndjekin trajnime të vazhdueshme dhe të kenë minimumi 10 raste azilkërkuesish në vit⁵.

15. Informacion i përshtatshëm për fëmijët rreth ndihmës juridike për fëmijët në konflikt me ligjin

● STANDARTET E BE-SË DHE NDËRKOMBËTARE

E drejta për tu informuar mbi të drejtën e ndihmës juridike për të gjithë personat në kontakt me sistemin e drejtësisë është e rregulluar në nivel ndërkombëtar dhe në të gjitha nivelet Europiane. Në përputhje me Direktivën 2012/13 të BE që parashikon të drejtën e personave të dyshuar apo akuzuar për tu informuar saktë mbi të drejtat e tyre, Direktiva 2016/800 e BE specifikon se fëmijët e dyshuar apo akuzuar duhet të informohen për të drejtën e tyre për ndihmë juridike. (Neni 6) Më specifikisht, ligji duhet të garantojë që “oficerët e policisë, prokurorët, oficerët gjyqësorë dhe zyrtarë të çdo institucioni ku personat

⁵ Raporti Final i Procedurës së Apelit të Azilit në Marrëdhënie me qëllimet e Sistemeve dhe Politikave Europiane të Azilit (2020). Qendra Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikave të Migrimit fq. 93: [https://icmpd.org/content/download/48402/file/The Asylum Appeals Procedure in Relation to the aims of European Asylum Systems and Policies.pdf](https://icmpd.org/content/download/48402/file/The%20Asylum%20Appeals%20Procedure%20in%20Relation%20to%20the%20aims%20of%20European%20Asylum%20Systems%20and%20Policies.pdf)

janë të paraburgosur apo të burgosur” informojnë personat e pa përfaqësuar mbi të drejtat e tyre lidhur me ndihmën juridike. (*Udhëzimet e KB mbi Ndhimën Juridike*, 2012, Udhëzimi 2)

Për më tepër, *Udhëzuesi i KE mbi Drejtësinë miqësore për Fëmijë* rikujton se fëmijët duhet gjithmonë të informohen menjëherë dhe saktë mbi të drejtat e tyre dhe se informacioni duhet të jepet “në një formë të përshtatshme për moshën dhe pjekurinë e tyre, në një gjuhë që e kuptojnë dhe duke marrë në konsideratë gjininë dhe kulturën e tyre”. (IV, A, 1, §1)

● PËRFITIMET DHE SFIDAT

Shpesh, kur ata janë për herë të parë në konflikt me ligjin, fëmijët nuk i dinë të drejtat e tyre procedurale, përfshirë dhe të drejtën për ndihmë juridike. Sidoqoftë, nëse ata janë të mirëinformuar mbi këtë të drejtë, kjo do të rrisë akasin efektiv në ndihmë juridike dhe të ulë shanset e refuzimit të përfaqësimit ligjor.

Për rrejdhojë, fëmijët në konflikt me ligjin janë shpesh të informuar në një formë që nuk është e përshtatshme për moshën dhe të kuptuarin e tyre. Sistemi ligjor dhe fjalori i tij janë tejet kompleks, duke mos lejuar kështu të kuptuarin efektiv. Është e nevojshme një përpjekje për të thjeshtëzuar dhe përshtatur këtë fjalor në mënyrë që fëmijët të mund të kuptojnë sistemin ligjor dhe të drejtat e tyre.



- Fëmijët duhet të informohen mbi të drejtat e tyre për pasur ndihmë juridike që në fillim te procesit. Informacioni duhet të jetë i përshtatur për specifikat e fëmijës (mosha, i kuptuari, gjuha, etj.) dhe konteksti po ashtu, si dhe të jepet në një formë që siguron të kuptuarin e tij nga fëmija.
- Për të siguruar që fëmija e kupton, informacioni mund të jepet me ndihmën e një deklaratë të drejtash miqësore për fëmijët. Duhet theksuar se megjithëse materialet e shkruara janë një praktikë e mirë, informacioni duhet gjithmonë të shpjegohet dhe gojarisht.
- Është thelbësore që informacioni mbi mundësinë e ndihmës juridike **të jepet sa më parë të jetë e mundur**. Kjo ndihmon në parandalimin e mospranisë së një avokati gjatë dëgjësive me policinë apo në gjyq si pasojë e mungesës së njohurisë mbi të drejtat e tij/saj.



- ✳ Në **Shqipëri**, në vijim të parashikimeve për procedurat penale, prokurori apo oficeri gjyqësor duhet të marrë masa të menjëhershme për të njoftuar fëmijën drejtpërdrejt apo përmes prindërve/përfaqësuesve ligjorë mbi të drejtën e ndihmës juridike falas, si dhe të çdo ndihme tjetër të nevojshme. Në fillim të intervistës me oficerin e policisë gjyqësore, fëmija informohet për Deklaratën e të Drejtave. Megjithatë, ekziston vetëm një lloj deklarate si për të rritur dhe për fëmijë. Kjo nënkupton se gjuha e përdorur nuk është e përshtatshme për fëmijët.

16. Informacion rreth ndihmës juridike

● STANDARTET E BE-SË DHE NDËRKOMBËTARE

Në përputhje me Udhëzuesin mbi Ndhimën Juridike të KB 2012, informacioni mbi ndihmën juridike duhet të jetë “i disponueshëm për komunitetin dhe për publikun e gjerë nga zyrat lokale qeveritare, institucione edukuese dhe fetare, si dhe përmes mediave përfshirë internetin apo forma të tjera të përshtatshme”. (Udhëzimi 2).

Udhëzuesi i KE mbi Drejtësinë miqësore për fëmijë specifikon se “materialet miqësore për fëmijë që përmbajnë informacion ligjor duhet të jenë të mundshme dhe të shpërndara gjerësisht”. (IV, A, 1).

● PËRFITIMET DHE SFIDAT

Studimi i projektit LA Child, i zhvilluar në 14 vende europiane nuk ka identifikuar ndonjë fushatë informuese mbi ndihmën juridike për fëmijë. Kjo sugjeron se ekzistojnë pak ose nuk ka asnjë fushatë në këto vende.

Akresi i lehtë në informacionin rreth ndihmës juridike duhet të ndihmojnë në rritjen e ndërgjegjësimit dhe njohurive mbi këtë të drejtë specifike për të gjithë. Nuk duhen edukuar vetëm fëmijët, por edhe prindërit dhe profesionistët që punojnë rregullisht me fëmijët. Njerëzit që punojnë me fëmijët dallojnë në formim dhe specializim, duke nënkuptuar kështu se çështjet ligjore mund të hiqen lehtësisht nga profesioni i tyre aktual. Sidoqoftë, edhe ata që nuk janë specialistë të ligjit mund të japin informacion të përgjithshëm dhe të dobishëm.



- Fëmijët nuk duhet të presin deri sa të jenë në konflikt me ligjin për tu informuar saktë për të drejtën e tyre për ndihmë juridike. Për rrjedhojë, autoritetet mund të
 - Zhvillojnë një fushatë informimi për të drejtat e fëmijëve përfshirë të drejtën e tyre për ndihmë juridike apo fushatë specifike për ndihmën juridike. Kjo fushatë duhet të jetë miqësore për fëmijët, pra të jetë lehtësisht e aksesueshme dhe kuptueshme.
 - Zhvillojnë edukimin mbi të drejtat dhe drejtësinë nëpër shkolla
 - Krijojnë materiale miqësore për fëmijë që përmbajnë informacion të përshtatshëm mbi të drejtën e fëmijës për ndihmë juridike, që të mund të shpërndahet në të gjitha institucionet dhe shërbimet përkatëse.
 - Edukojnë profesionistët që punojnë me fëmijët (si mësuesit, shërbimet sociale etj.) që të mund të përdorin këtë informacion gjatë punës me fëmijën.



- Në **Finlandë**, të gjithë gjimnazistët e vitit të parë marrin pjesë në leksione mbi sistemin ligjor si pjesë e kurrikulës së studimeve sociale;
- Në **Beljikë**, Projekti DCI (“Dans la peau de...”) ka si qëllim ndërgjegjësimin dhe informimin e fëmijëve mbi drejtësinë për fëmijë. Në shkollë mbahen workshop-e që edukojnë studentët në lidhje me të drejtën e fëmijëve në procedime ligjore (përfshirë aksesin në ndihmë juridike) si dhe aktorët përkatës, filozofia dhe hapat proceduralë për fëmijët në konflikt me ligjin.

17. Standarte për avokatët e ndihmës juridike që punojnë me fëmijë

• STANDARTET E BE-SË DHE NDËRKOMBËTARE

Udhëzimet dhe Parimet e KB 2012 shprehen se është e nevojshme për autoritetet të vendosin “standarte shërbimi për ndihmën juridike dhe kod profesional sjelljeje” (Parimi 11, §58).

● PËRFITIMET DHE SFIDAT

Udhëzuesit për avokatët që punojnë me fëmijët duhet të vendosin një standart për ofrimin e ndihmës juridike. Për më tepër, një instrument i tillë do të rriste ndërgjegjësimin për rolin e avokatit që ofron ndihmë juridike për fëmijët dhe mbi çështje specifike që duhen konsideruar në lidhje me komunikimin dhe ofrimin e ndihmës juridike për fëmijë. Ekzistenca e dokumenteve profesionale mbështetës që qartësojnë rolin e avokatit në rrethana të ndryshme ndihmojnë avokatët që të kryejnë më së miri detyrën e tyre, si dhe të sigurojnë që të drejtat e fëmijëve po respektohen.



- ➔ Autoritetet e ndihmës juridike duhet të përshtasin udhëzuesit mbi ofrimin e ndihmës juridike për fëmijët në konflikt me ligjin, në mënyrë që ato të bëhen një manual për tu përdorur nga avokatët, si dhe pikë reference për trajnime. Një dokument i tillë mund të bazohet në këtë Udhëzuesin aktual, të përshtatur në kontekstin vendas.



- * **UNICEF ECARO** zhvilloi *Udhëzuesin mbi ndihmën juridike miqësore për fëmijë* (2018), një mjet praktik për të mbështetur profesionistët e rinj dhe ata me eksperiencë, në punën e tyre të përditshme direkte me të drejtat e fëmijëve. Udhëzuesi i drejtohet avokatëve të financuar nga shteti dhe atyre privatë, paraligjorëve dhe profesionistëve të tjerë ligjorë, të cilët ofrojnë ndihmë juridike për fëmijë në procedime civile, penale, administrative dhe të drejtësisë restauruese, si dhe që përfaqësojnë fëmijët në çështje drejtuar nga organe kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare të monitorimit të të drejtave të njeriut.
- Në kuadër të projektit European Avokati im, **të drejtat e mia**, është zhvilluar një guidë praktike për avokatët që përfaqësojnë fëmijët në konflikt me ligjin.
- Në Republikën Çeke ekziston një dokument në nivel kombëtar i quajtur Standartet e Punës për Zbatimin e Mbrojtjes Sociale dhe Ligjore për Fëmijët që mund të konsiderohet si një set special udhëzimesh mbi ofrimin e ndihmës juridike për fëmijë.

18. Monitorimi i ndihmës juridike i ofruar për fëmijët dhe procedurat e ankimimit.

● STANDARTET E BE-SË DHE NDËRKOMBËTARE

Rritja e cilësisë së ndihmës juridike po merr vëmendje të rritur në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Për rrjedhojë, Udhëzimet dhe Parimet e KB 2012 shprehen se “ofruarit e ndihmës juridike që punojnë me dhe për fëmijët duhet t’i nënshtrohen vettingut rregullisht kur është e nevojshme për të siguruar qëndrueshmëri në punën e tyre me fëmijë”. (Parimi 11, §58)

Udhëzimet e KE mbi Drejtësinë miqësore për Fëmijë përmend se “fëmijët duhet të kenë të drejtën për akses në mekanizma të përshtatshëm të pavarur dhe efektive të ankimimit”; kjo duhet të aplikohet gjithashtu në kuadrin e ndihmës juridike.

● PËRFITIMET DHE SFIDAT

Një mënyrë për të siguruar cilësinë e ndihmës juridike për fëmijë është zbatimi i një sistemi monitorimi që mbikqyr punën e avokatëve me fëmijët. Kjo mund të shtonte masat për përfaqësimin ligjor efektiv dhe eficient të fëmijëve në konflikt me ligjin. Deri më sot, shumë vende Europiane nuk e kanë ende një strukturë apo një udhëzues për të vlerësuar cilësinë e ndihmës juridike që i ofrohet fëmijëve dhe në vendet ku ky system ekziston, duket se nuk është mjaftueshëm efektiv.

Monitorimi i punës së avokatëve është një çështje e verifikimit të aftësisë dhe qëndrueshmërisë së tyre për të punuar në përshtatje me fëmijët në konflikt me ligjin. Në mënyrë që të realizohet një vlerësim i vërtetë i profesionistëve të ndihmës juridike, do të ishte efektiv monitorimi i shumë elementëve, si aftësia e tyre, por edhe mbështetja që ofrojnë, kapaciteti për të bashkëpunuar me profesionistë të tjerë në interes të fëmijës, njohuritë ligjore dhe aftësitë komunikuese për fëmijët që ata përfaqësojnë.

Dhomat e avokatisë, të cilat në disa aspekte duken të jetë kandidatët idealë për kryerjen e këtyre kontrolleve për shkak të pavarësisë së tyre, nuk kanë burimet e nevojshme për të kryer verifikime dhe për të kontrolluar në formë të përshtatshme. Mekanizmat sistematikë të monitorimit duket se janë të nevojshëm për të ndihmuar në kontrollin e cilësisë së ndihmës juridike e ofruar për fëmijët.

Në shumë raste, mekanizmi kryesor i kontrollit të cilësisë është vlerësimi i ankesave marrë nga përfituesit e ndihmës juridike. Në shumë vende, plotësimi i një ankese nga marrësit e shërbimit është forma e vetme për të shprehur opinionin mbi shërbimet e ndihmës juridike. Sidoqoftë, kjo praktikë përdoret shumë rrallë sidomos në çështjet e fëmijëve, pasi procedura e ankesës është e panjohur ose perceptohet si e vështirë.



- Dhomat e Avokatisë duhet të organizojnë dy lloje kontrollesh: a posterior (marrjen e ankesave) dhe a priori (peer review, kërkesa të rregullta, kontroll dhe trajnim vazhdues). Këto mekanizma supozojnë se “supervisorëve” nga dhomat e avokatisë iu është dhënë kohë dhe burime të mjaftueshme, si dhe pavarësi në mënyrë që kontrolli i cilësisë të jetë efektiv.
- Fëmijët në konflikt me ligjin duhet t'i kenë rrugët e ankimit të hapura dhe të kenë të drejtën për të bërë ankesa – bazuar në konfidencialitet- tek një autoritet i pavarur.
 - Procedura e ankimit duhet të jetë e **përshtatur për përdorim nga fëmijët**. Këto procedura duhet të jene të thjeshta dhe miqësore për fëmijë, veçanërisht në lidhje me gjuhën e përdorur.
 - **Zgjidhjet dixhitale për të dërguar ankesën** duhet të merren në konsideratë (p.sh aplikacione në pajisje tek të cilat fëmijët kanë akses)
 - **Duhet të merren në konsideratë** mjete që garantojnë mekanizma ankimi efektive, të pavarura dhe konfidenciale.



- Në Belgjikë, cilësia e ndihmës juridike monitorohet dhe vlerësohet nga Dhoma e Avokatisë. Përmbledhja mbi Ndhmën Juridike Dytësore specifikon se kontrolli i cilësisë së shërbimeve aplikohet në dy nivele:
 - *Ex ante, që lidhet veçanërisht, me arsyetimin e orientimeve të deklaruar ose angazhimin për të ndjekur një kurs trajnimi, i cili kushtëzohet përfshirjen ose jo në listën e avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike*
 - *Ex post, që lidhet me efektivitetin dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara, që mund të lejojë Këshillin e Dhomës që ta përfshijë avokatin në listë nën disa kushte specifike, ta pezullojë apo të përjashtojë atë nga lista.*

PJESA 2

UDHËRRËFYES PËR AVOKATËT

Hyrja: Të sigurojmë që interesi më i lartë i fëmijës është konsideratë parësore

Neni 3 i **Konventës Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijës** artikulon se interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsideratë parësore në të gjitha veprimet që lidhen me fëmijët. Mirëqenia e fëmijës në konflikt me ligjin duhet të jetë kështu gjithmonë një faktor përcaktues në vlerësimin e çështjes së tij/saj.

Ky parim ka gjithashtu pasoja për punën e avokatit. Roli i avokatit është të mbrojë të drejtat e klientit të tij/saj dhe të veprojë si zëdhënësi i tij. Bazuar në interesin më të lartë të fëmijës, roli kryesor i avokatit është **të sigurojë që ky interes është vlerësuar si duhet dhe është marrë në konsideratë në çdo vendim që lidhet me fëmijën** (vendim i marrë nga një gjyqtar, një vendosje në një institution etj). Prandaj, avokati duhet të jetë në gjendje të vlerësojë çdo efekt (pozitiv ose negativ) të të gjitha vendimeve që mund të ndikojnë tek fëmija dhe tek mirëqenia e tij/saj fizike dhe psikologjike. Roli i avokatit si zëdhënës është vendimtar në këtë kuptim duke qenë se ai duhet të sjellë zërin e fëmijës tek autoriteti vendimmarrës (gjyqtari) dhe interesi më i lartë i fëmijës duhet të vlerësohet duke marrë në konsideratë kritere të ndryshme, përfshirë opinionin e fëmijës.

Sipas udhëzuesit të Këshillit të Europës për drejtësinë miqësore me fëmijët, një avokat nuk duhet të sjellë atë që ai ose ajo konsideron si interesi më i lartë i fëmijës (siç bën kujdestari apo një mbrojtës i caktuar nga shteti) por duhet të përcjellë dhe të mbrojë pikëpamjet dhe opinionet e fëmijës, siç bën në rastin e një klienti të rritur.

Avokati duhet të kërkojë informimin e miratuar të fëmijës lidhur me strategjinë më të mirë që ai do të përdorë. Nëse avokati nuk bie dakort me opinionin e fëmijës, ai ose ajo duhet të përpiqet të bindë fëmijën, siç do të bënte në rastin e çdo klienti tjetër. “Fëmijët duhet të konsiderohen si klientë të mirëfilltë me të drejtat e tyre dhe avokatët që përfaqësojnë fëmijët duhet të përcjellin opinionin e fëmijës”.

Në disa situata, marrja e rolit të zëdhënësit të fëmijës mund të bëjë që avokati të debatojë për gjëra që nuk janë në fakt në interesin më të lartë të fëmijës. Gjithsesi, ai ose ajo ka detyrën të përcjellë zërin e fëmijës tek autoritetet që marrin vendimin.

19. Disponueshmëria dhe pjesëmarrja e ofruesit të ndihmës juridike në çdo fazë të procedurës

● STANDARTET E BE-SË DHE NDËRKOMBËTARE

Direktiva e BE 2016/800 kërkon që shtetet anëtare të sigurojnë që “fëmijët asistohen nga një avokat pa vonesa menjëherë pasi ata bëhen të dyshuar apo të akuzuar”. Kjo direktivë liston të gjitha fazat e procedurës në të cilën fëmija është veçanërisht i rëndësishëm: para seancës dëgjimore, gjatë veprimeve hetimore apo mbledhjes së evidencave, pa vonesë pasi është privuar nga liria apo në kohën e duhur para se ai/ajo të paraqitet në Gjykatë. (Neni 6).

● PËRFITIMET DHE SFIDAT

Prezenca e ofruesit të ndihmës juridike në faza të ndryshme të procedimeve është një garanci e rëndësishme për respektimin e të drejtave procedurale të fëmijës. Më tej, prezenca e një dhe të njëjtit avokat përgjatë procedurës është thelbësore për një marrëdhënie besimi me fëmijën dhe po ashtu për cilësinë e përfaqësimit.

Disponueshmëria e ofruesit të ndihmës juridike, sidomos e të njëjtit avokat përgjatë procedurës, është një sfidë domethënëse në kushtet kur hapat e rëndësishëm në procedurë zakonisht nuk janë planifikuar më pare duke marrë parasysh edhe disponueshmërinë e avokatit, por vetëm nevojat e hetimit apo procedurës. Gjithashtu, barrierat ligjore apo financiare mund të pengojnë prezencën e avokatit në çdo fazë të procedurës, psh. nëse avokatët nuk paguhen nga “ndihma juridike” për numrin e shërbimeve të kërkuara.



- ➔ Të jeni në kohë në Gjykatë ose në polici;
- ➔ Të njoftojë Gjykatën apo Komisarlatin e Policisë nëse ju nuk mund të arrini në kohë në mënyrë që ata të gjejnë një avokat zëvendësues për fëmijën;
- ➔ Të informoni fëmijën për këtë zëvendësim ;



- Në mënyrë që të sigurohemi që klienti i mitur do të asistohet në çdo fazë të procedurës, disa avokatë të përfshirë në studimin e LA Child në Belgjikë thanë se ata kishin të zgjedhur të punonin në “çift”. Në këtë situatë, fëmija ka një avokat si referencë, nëse ai nuk është i disponueshëm, mund të zëvendësohet nga partneri i tij/saj për të asistuar fëmijën në disa pika të procedimit.

Kjo ka disa avantazhe:

- Ndhmon të parandalohet mungesa e avokatit në çdo fazë të procedimit.
- Avokati mund të informojë fëmijën më parë se ai ose ajo mund të zëvendësohet nga një koleg i besuar (kur është e mundur të parashikojë më parë këtë zëvendësim). Në këtë mënyrë, fëmija nuk befashohet nga prezenca e këtij avokati dhe besimi ruhet.
- Avokati i ri mund të udhëzohet nga avokati i referencës para takimit me fëmijën. Kjo bën të mundur që fëmija të mos përsërisë veten dhe të mos ketë problematika me avokatin e ri.
- Avokati i referencës mundet kështu të sigurojë një informacion të duhur për vijimin duke u konsultuar me kolegun që e ka zëvendësuar.

20. Mbrojtja e Fëmijës

• STANDARTET E BE-SË DHE NDËRKOMBËTARE

Në përputhje me Direktivën e **BE 2016/800**, fëmijët duhet të asistohen nga avokatët, “në mënyrë që t’i lejojnë atyre të ushtrojnë të drejtën e mbrojtjes në mënyrë efektive” (neni 6, 2)

Parimet dhe Udhëzimet e KB të vitit 2012 për ndihmën juridike risjellin “të drejtën (për fëmijët) për të patur asistencë juridike dhe asistencë tjetër në përgatitjen dhe prezantimin e mbrojtjes së tij/saj.” (Udhëzues 11, 58, b)”

• PËRFITIME DHE SFIDA

Për shkak se fëmijët janë vulnerabël dhe nuk kanë të njëjtin kapacitet për të kuptuar sistemin ligjor si të rriturit, mbrojtja e të drejtave të tyre mbështetet edhe më shumë tek avokati. Mbrojtja e fëmijës nënkupton garantimin e respektimit të të drejtave të tyre dhe kërkimin në emër të tyre tek gjyqtari.

Gjithashtu, një nga avokatët e intervistuar në studimin e LA Child pohoi se roli i i tij është «të bëjë jo vetëm një lexim të situatës në interesin e fëmijës, por një lexim ligjor». Avokati i fëmijës ka një rol të veçantë në sigurimin që të drejtat procedurale janë respektuar. Ajo ilustron «për shembull, nëse fytyra e fëmijës nuk është e sfumuar nga kamera e sigurisë, ju duhet të insistoni për këtë gjë, askush tjetër nuk do mendojë për këtë gjë.»



- Avokati duhet të pregatisë mbrojtjen ligjore të klientit fëmijë. Kjo nënkupton reflektimin e strategjisë më të mirë të mbrojtjes me pjesëmarrjen e fëmijës, dhe duke marrë parasysh nevojat e po ashtu dëshirat e tij/saj.
- Roli tjetër kryesor i avokatit është të sigurojë që të gjitha të drejtat e fëmijës janë respektuar siç duhet, sidomos të drejtat procedurale si: e drejta për konfidencialitet dhe privatësi, e drejta për tu informuar, e drejta për pjesëmarrje etj.

21. Aksesi në informacionin e duhur

● STANDARTET E BE-SË DHE NDËRKOMBËTARE

Direktiva e BE 2016/800 citon të drejtën e fëmijës për tu informuar: “kur fëmijët janë informuar se ata janë të dyshuar apo të akuzuar në ponedime penale, ata informohen në kohë për të drejtat e tyre në përputhje me Direktivën 2012/13/BE dhe rreth aspekteve të përgjithshme të rregullave të procedurës.”(neni 4)

Kjo e drejtë për informacion është risjellë në Udhëzuesin e KE për Drejtësinë Miqësore me Fëmijët, që liston informacionin që i duhet dhënë fëmijëve “që nga përfshirja e tyre e parë e me sistemin e drejtësisë”. Informacioni mbi të drejtat e tyre, mbi funksionimin e sistemit të drejtësisë dhe procedurave, akuzat kundër tyre, dhe mbi progresin e përgjithshëm ndaj procesit, janë të gjitha lloje informacioni të listuara që i duhen komunikuar fëmijëve, gjithmonë në një mënyrë të përshtatur me nivelin e tyre të të kuptuarit. (IV, A, 1, 1.)

● PËRFITIMET DHE SFIDAT

Informimi i fëmijës dhe të siguruarit se ai/ajo kupton aspektet e procedurës për të ushtruar të drejtat me njohuri të plota mbi faktet është një parakusht për të ushtruar të drejtën e fëmijës për tu dëgjuar.

Aftësia e fëmijës për të kuptuar, kujtuar dhe asimiluar informacionin që avokati i tij/saj

i komunikon atij varet nga shumë faktorë duke përfshirë moshën e fëmijës, pjekurinë, aftësinë gjuhësore, eksperiencat e kaluara, nivelet aktuale të energjisë dhe gjendjen emocionale.

Sidoqoftë, në shumë raste, avokatët nuk kanë kohë t'i shpjegojnë gjithë procedurën fëmijës në detaje. Nganjëherë, avokatët e takojnë fëmijën në kohën e seancës dhe nuk kanë kohë t'i shpjegojnë gjithë procedurën në detaje.



- Avokati është një bashkëbisedues i privilegjuar me fëmijën përgjatë gjithë procedurës. Prandaj, ai/ajo ka detyrë ta informojë fëmijën rreth informacionit specifik që lidhet me të drejtat e tij/saj dhe procedurën.
- Lidhur me informacionin për të drejtat dhe procedurën, avokati duhet t'i "japë fëmijës informacionin më të detajuar e të përshtatshëm rreth situatës" (raporti LA Child), avokati duhet:
 - Të japë informacionin në një mënyrë të përshtatshme për çdo fëmijë: duke marrë në konsideratë moshën, kapacitetin për të kuptuar, vulnerabilitetin, eksperiencën dhe njohurinë e tij/saj për drejtësinë, si dhe gjendjen emocionale;
 - Duke marrë këtë në konsideratë, avokati duhet të japë informacionin më të qartë, të përshtatshëm për situatën dhe më të plotë të mundshëm;
 - Kujdesuni që mos të mbingarkoni fëmijën me shumë informacion. Është një çështje e balancës midis detyrimit për të dhënë informacion dhe nevojave të fëmijës, të cilat avokati duhet t'i analizojë për çdo rast individual.
- Midis informacionit të rëndësishëm që fëmija duhet të marrë, avokati duhet të shpjegojë:
 - Akuzat kundër tij/saj;
 - Rolin e avokatit;
 - Logjikën mbrojtëse të sistemit të drejtësisë për fëmijë;
 - Si procedura do të zërë vend, roli i aktorëve të ndryshëm dhe rezultatet e mundshme;
 - Mundësia për apel;
 - Të drejtat specifike të fëmijës në çdo fazë të procedimit (psh. e drejta për të qëndruar në heshtje, për të kërkuar ndërprerjen e një seance në mënyrë që të flasë me avokatin e tij/saj, për të mos ju përgjigjur pyetjeve të caktuara e kështu me rradhë)

«Nganjëherë ju gjendeni të përfshirë në një situatë dhe fokusoheni tek faktet, dhe në ato pak raste që unë nuk i kam shpjeguar të drejtat siç duhet, kam ndjerë keqardhje. (E drejta për të heshtur për shembull). Ju duhet të insistoni në këtë gjë, sepse disa herë gjatë seancës, ata nuk kujtojnë mirë, dhe ata do të shpikin çdo gjë për të qenë në gjendje të përgjigjen.» Avokat i fëmijëve në Belgjikë



- * Praktikë e mirë për të përcjellë këtë informacion tek fëmijët është të zhvillohen disa materiale miqësore për fëmijët që përmbajnë informacion të rëndësishëm ligjor dhe ta bëjmë këtë gjërisht të aksesueshme, siç sugjerohet në Udhëzuesin e KE për Drejtësinë miqësore me Fëmijët. (IV, A, 1)
- * Në Belgjikë, projekti i DCI-Belgium CRBB 2.0 ka krijuar dhe regjistruar disa “podcast” miqësore për fëmijët që shpjegojnë rolin e aktorëve të ndryshëm në drejtësinë për të mitur (avokat, gjyqtar etj.) për t’i ndihmuar të bëhen familjar me sistemin e drejtësisë.

22. Roli i avokatit si përfaqësues i zërit të fëmijës

● STANDARTET E BE-SË DHE NDËRKOMBËTARE

Avokati duhet të përçojë zërin e fëmijës, siç theksohet në **Udhëzuesin e Këshillit të Europës për Drejtësinë Miqësore me Fëmijët**: “Fëmijët duhen konsideruar si klientë të plotë me të drejtat e tyre dhe avokatët që përfaqësojnë fëmijët duhet të përcjellin opinionin e fëmijës.” (IV, D., 2., §40), edhe nëse ai ose ajo nuk bie dakort me opinionet e fëmijës, siç specifikon Udhëzuesi i UNICEF në udhëzimin 2: “Është shumë e rëndësishme që përfaqësuesi ligjor i fëmijës të mos neutralizojë zërin e fëmijës nëse përfaqësuesi nuk bie dakort me këndvështrimin që fëmija shpreh, pasi roli i përfaqësuesit është të arrijë pranimin e informuar të fëmijës për strategjinë më të mirë që do të përdorë. »

“Roli juaj është të jeni zëdhënësi i fëmijës. Pyeteni atë se çfarë do ai të kërkojë dhe thuajani gjyqtarit, e më pas, ndihmoheni atë ta thotë” Avokat i fëmijëve në Belgjikë

● PËRFITIMET DHE SFIDAT

Komunikimi me fëmijët, sidomos kur ata janë të vegjël apo kur iu mungon matura, nuk është i lehtë. Është shpesh shumë e vështirë për avokatët të dinë si të përfaqësojnë në mirë opinionet e tyre në raste të tilla. Të përcjellësh vërtet fjalën e fëmijës siguron që interesi më i lartë i fëmijës është marrë në konsideratë dhe që të drejtat e fëmijës për tu dëgjuar dhe për të marrë pjesë (edhe në mënyrë indirekte) janë respektuar.



- Avokati ka funksionin e forcimit të pozicionit subjektiv të fëmijës në çështje dhe të kompensojë mungesën e tij/saj të njohurive dhe eksperiencës për kulturën gjyqësore dhe sistemin gjatë procedurës. Avokati duhet të marrë në konsideratë pikëpamjet e fëmijës dhe t'i japë atyre peshën e duhur gjatë procedurës. Ai/ajo duhet gjithashtu të respektojë opinionet e fëmijës edhe nëse ai/ajo nuk bie dakort me ta. Në këtë rast, roli i tij/saj është të këshillojë fëmijën për pasojat e vendimeve të tij/saj por në fund të respektojë atë që fëmija kërkon.
- Avokati duhet:
 - Të jetë i sigurtë se ai/ajo i kupton mirë kërkesat e fëmijës;
 - T'i komunikojë qartë Gjykatës dhe autoriteteve të tjera përkatëse interesat, këndvështrimet dhe ndjenjat e fëmijës;
 - Ta informojë në mënyrë të përshtatshme fëmijën rreth impaktit të pjesëmarrjes së tij;
 - Të verifikojë që vendimet e gjyqtarit i kanë dhënë peshën e duhur opinionit të fëmijës;
 - Të inkurajojë dhe të sigurojë pjesëmarrjen e fëmijës;
 - Të mbrojë dhe të ndërhyjë kur mjedisi është i papërshtatshëm ose armiqësor për pjesëmarrjen e fëmijës- për shembull nëse pyetjet që shtrohen janë keqduhëzuese apo mund të influencojnë përgjigjen, ose nëse publiciteti i seancës mund të ketë efekt negative në pjesëmarrjen e fëmijës;
 - Të kontrollojë që procesi i përshtatet fëmijës dhe të kërkojë pauza kur nevojitet;
 - Të sigurojë që pjesëmarrja e fëmijës nuk e ekspozon atë në rrisqe të ndryshme;
 - T'i japë fëmijës një informacion mbi vendimin e gjyqtarit dhe për përmasën në të cilën gjyqtari ka marrë në konsideratë kërkesat dhe nevojat e fëmijës;
 - Të sigurojë që fëmija nuk sforcohet për të marrë pjesë kundër dëshirës së tij/saj. Fëmijët duhet të informohen që ata mund ta ndalojnë pjesëmarrjen e tyre në çdo kohë por gjithashtu edhe për pasojat që kjo mund të ketë.

23. Përfaqësimi i fëmijës, jo i prindërve të tij/saj apo kujdestarëve ligjor

● STANDARTET E BE-SË DHE NDËRKOMBËTARE

Udhëzimet dhe Parimet e KB të vitit 2012 mbi ndihmën juridike theksojnë se fëmijët kanë “të drejtën (...) për të patur një avokat të caktuar për ta përfaqësuar fëmijën në emrin e tij/saj në procedime kur ka ose mund të ketë një konflikt interesi midis fëmijës dhe prindërve të tij/saj apo palëve të tjera të përfshira”.

Udhëzimet e KE për Drejtësinë miqësore me Fëmijët, sjellin të njëjtin rekomandim: “fëmijët duhet të kenë të drejtën për të patur avokatin e tyre dhe përfaqësim në emrin e tyre, në procedime kur ka ose mund të ketë konflikte interesi midis fëmijës dhe palëve të tjera të përfshira.”(IV, D., 2., §37)

● PËRFITIMET DHE SFIDAT

Për shkak të moshës dhe mungesës së pjekurisë, në disa raste është e vështirë për avokatin të jetë i sigurtë që opinionet dhe dëshirat e fëmijëve nuk janë influencuar nga prindërit e tij apo nga të rritur të tjerë.

Avokati duhet t'i referohet gjithmonë vetëm asaj që fëmija shpreh dhe kërkon. Fëmija është klienti kryesor. Është e rëndësishme që fëmija të ndiejë se ai/ajo është në qendër të procedimeve dhe jo që të rriturit të diskutojnë e të vendosin për çështjen e fëmijës pa përfshirjen e tij/saj. Gjithashtu, respektimi i opinionëve dhe dëshirave të fëmijës ndihmon në ndërtimin e besimit midis avokatit dhe klientit të tij/saj.

Në një rast ku ka konflikt interesi, është edhe më e rëndësishme që avokati të marrë një qëndrim të qartë për fëmijën se kjo ndihmon që fëmija të ndjehet i mbështetur.



- Një profesionist ligjor duhet të veprojë **sipas udhëzimeve të fëmijës dhe në interesin më të mirë të tij** e jo të anëtarëve të familjes/përfaqësuesve ligjor.



- Në **Lituani**, çështja e konfliktit të interes midis të miturit dhe prindërve është adresuar nga Kodi i Procedurës Penale, i cili thotë se përfaqësuesit ligjor mund të marrin pjesë në procedime dhe të mbrojnë interesat e të miturit përveç se kur ato interesa janë në kundërshtim me interesat e të miturit.

24. Sigurimi i konfidencialitetit

● STANDARTET E BE-SË DHE NDËRKOMBËTARE

Direktiva e BE 2016/800 rikujton detyrimin e Shteteve për të siguruar që fëmijët të kenë të drejtën të takohen privatisht dhe të komunikojnë me avokatin që i përfaqëson gjatë të gjitha fazave të procedurës. Direktiva thekson se konfidencialiteti në çdo formë komunikimi që mund të ndodhë midis fëmijës dhe avokatit të tij si takime, biseda telefonike dhe forma të tjera korrespondence duhet të respektohen siç duhet (neni 6. 4. a & b)

● PËRFITIMET DHE SFIDAT

Ambjentet ku komunikimi me fëmijën ndodh nuk janë gjithmonë të përshtatshme; psh. ato nuk janë gjithmonë të izoluara akustikisht.

Zakonisht, përfaqësuesit e fëmijës (prindërit, kujdestarët dhe të tjerë) kanë të drejtën të marrin pjesë në intervistat e fëmijës me avokatin. Sidoqoftë, në disa raste ku interesi më i lartë i fëmijës mund të dëmtohet ose kur fëmija nuk do që ata të jenë prezent, fëmijës duhet t'i jepet mundësia për të qenë vetëm në intervistë. Avokatët belgë që morën pjesë në studimin e projektit LA Child pohuan se, nëse një fëmijë nuk dëshiron që prindërit/kujdestarët apo ndonjë person tjetër të marrë pjesë në takim, atëherë avokatët duhet të marrin një kohë për të komunikuar me ato palë para ose pas takimit konfidencial me fëmijën



- Të sigurojmë kushtet e përshtatshme për intervistën me fëmijën në termat e privatësisë dhe konfidencialitet si psh. të zhvillohen intervistat në dhoma të izoluara akustikisht pa prezencën e palëve të treta (përveç se kur është në interesin më të mirë të fëmijës).
- Të respektojmë dëshirat e fëmijës dhe kur është e përshtatshme dhe në interesin më të lartë të fëmijës, t'i japim atyre mundësinë të flasin pa pjesëmarrjen e prindërve, kujdestarëve apo përfaqësuesve të tjerë ligjorë.



- Në **Belgjikë**, Kodi i Etikës si i Dhomave të Avokatisë frengjishtfolëse dhe gjermanfolëse shpreh qartë se avokatët që asistojnë një fëmijë të privuar nga liria në një pyetje në polici duhet të kenë një konsultim konfidencial me fëmijën para kësaj seance. (neni. 2.24). Kodi po ashtu thekson se avokatët që do të asistojnë një fëmijë që nuk është i privuar nga liria dhe është thirrur të dëgjohet, mund ta mbajnë këtë konsultim konfidencial në zyrën e tyre, dhe nëse kjo nuk është e mundur në vendin e seancës, duke u siguruar që të kenë mjaftueshëm kohë që ky konsultim të jetë i dobishëm. Po ashtu, kur avokatët janë në detyrë në Gjykatën e të Rinjve, takimi i parë me fëmijën ndodh në gjykatë. Në disa gjykata, një dhomë është e dedikuar për këtë qëllim.

25. Përfaqësimi i një fëmije të privuar nga liria

• STANDARTET E BE-SË DHE NDËRKOMBËTARE

Standartet e BE dhe ato ndërkombëtare kanë vendosur të drejta specifike procedurale për fëmijët lidhur me privimin nga liria, duke përfshirë kufizimin e përdorimit të saj si masë e fundit dhe për një kohën më të shkurtër të mundshme, e po ashtu nevojën për ta rishikuar atë vazhdimisht. Neni 10 i Direktivës së BE 2016/800 sidomos i ofron këto garanci. Kjo direktivë, në konsistencë me KDF, përshkruan trajtimin specifik për tu ndjekur në rastin e privimit nga liria (neni 12) dhe rekomandon që Shtetet Anëtare të fokusohen së pari tek alternativat e dënimit (neni 11).

Aksesi i shpejtë në ndihmën juridike është një e drejtë thelbësore kur ai/ajo është privuar nga liria dhe është e parashikuar në nenin 37 Konventës së të Drejtave të fëmijës dhe ofrohet në standarte të tjera ndërkombëtare. Komiteti i KB për të Drejtat e Fëmijës specifikon se: “nuk duhet të ketë kufizime në aftësinë e fëmijës për të komunikuar në mënyrë konfidenciale dhe në çdo kohë me avokatët e tij.” (CRC/C/GC/24, §95, e)

• PËRFITIMET DHE SFIDAT

Fëmijët në konflikt me ligjin mund të privohen nga liria në faza të ndryshme të procedurës dhe duke përfshirë arrestimin dhe ndalimin nga policia, paraburgimin dhe burgimin pas dënimit.

Sigurimi i aksesit të duhur në ndihmën juridike për këta fëmijë është shumë e rëndësishme sepse forcon respektimin e të drejtave thelbësore gjatë ndalimit, por gjithashtu edhe mbrojtje nga dhuna (duke përfshirë torturën dhe të tjera trajtime jonjerëzore apo johumane), akses në edukim dhe mbajtjen e kontaktit me familjen e

tyre. Kjo është thelbësore se fazat e rëndësishme të procedurës

dhe vendimet që lidhen me fëmijën do të ndërmerren rregullisht dhe kjo kërkon që fëmija të pregatisë mbrojtjen e tij me përfaqësuesit e tij/saj.

E megjithatë, privimi nga liria ka efektin e izolimit të fëmijës dhe kjo mund të konsiderohet, nëse jo e pakapërcyeshme, por minimalisht një barrierë në aksesin e fëmijës për ndihmë juridike. Në fakt, refuzimi apo mungesa e bashkëpunimit të institucionit ku fëmija mbahet i privuar nga liria, është një pengesë e madhe.

Për shembull, aksesin e fëmijës në ndihmë juridike mund të kufizohet nga aksesin e pakët për telefon apo mjete të tjera të përshtatshme komunikimi për të kontaktuar përfaqësuesin e tij/saj. Nga ana tjetër, sigurimi i konfidencialitetit të shkëmbimeve që ndodhin në telefon apo në takime me prezencë fizike mund të mos jenë të mundura për shkak të rregullave institucionale apo mungesës së ambjenteve të përshtatshme.

Po ashtu, disponueshmëria apo mungesa e avokatit mund të bëhet edhe më problematike kur fëmija është i privuar nga liria. Të vizitosh fëmijën klient në institucion është shumë e rëndësishme në mënyrë që të pregatiteni për hapat e mëtejshëm të procedurës, duke siguruar që të drejtat e tij respektohen si dhe të ndërtohet apo ruhet besimi midis avokatit dhe klientit të tij. Kjo ndihmon gjithashtu për të siguruar që avokati është i vetëdijshëm për realitetin e masave dhe ndikimin e tyre tek klienti i ri/e re, në mënyrë që ta përfaqësojë atë sa më mirë të jetë e mundur. Sidoqoftë, vizitat mund të jenë konsumuese në kohë për avokatët e prandaj ata shpenzojnë pak kohë për të bërë këtë gjë.



- Kur klienti i tyre fëmijë është i privuar nga liria, ofruesit e ndihmës juridike duhet të përpiqen sa më shumë që të:
 - Të vizitojnë të paktën një herë në person fëmijën në institucion. psh. para seancës për të kryer konsultimin;
 - Të verifikojnë që të drejtat procedurale dhe thelbësore të klientit të tyre të ri po zbatohen;
 - Të verifikojnë që kur konsultimi kryhet në telefon, garancitë e konfidencialitetit janë respektuar.



- Në Belgjikë, një nga avokatët e intervistuar tha se ajo sigurohet që të vizitojë të gjithë klientët e saj fëmijë të paktën një herë kur ata vendosen në një qendër paraburgimi/burgimi.

“A vizitoni ju në institucion çdo fëmijë klient që keni?”

“Gjithmonë të paktën një herë, edhe nëse kam një axhendë të ngarkuar. Ideja është të shoh se si ai është përshtatur në institucion, nëse ai ndjehet komod atje. Kjo është gjithashtu një mundësi për të shkuar më tej duke i shpjeguar të drejtat e tij. Ky takim është gjithashtu i nevojshëm për tu pregatitur për seancën, kështu që ai fuqizohet dhe është i aftë t'i paraprijë seancës, e cila zakonisht zhvillohet pak javë më vonë”

Ekstrakt i intervistës së zhvilluar me një avokat të fëmijëve në Belgjikë

26. Nevoja për trajnime vazhduese multidisiplinare

● STANDARTET E BE-SË DHE NDËRKOMBËTARE

Udhëzuesi i KE për drejtësinë miqësore për fëmijë vë në dukje nevojat kryesore në raport me trajnimin e avokatëve: “Të gjithë profesionistët që punojnë me dhe për fëmijët duhe të marrin trajnime multidisiplinare të nevojshme mbi të drejtat dhe nevojat e fëmijëve të grupmoshave të ndryshme dhe në procedime që janë të përshtatura për to. Profesionistët që kanë kontakt direkt me fëmijët duhet të trajnohen në komunikimin me fëmijët e të gjitha moshave dhe stadeve të zhvillimit, si dhe me fëmijët në situatë të një vulnerabiliteti të veçantë.” (IV, A, 4.5). Në këtë aspekt, Rregullat e Beijing specifikojnë se “për të gjithë [personelin që trajton çështjet e të miturve], një minimum trajnimi në ligj, sociologji, psikologji, kriminologji dhe shkenca të sjelljes është i nevojshëm.” (Rregulli 22.1) Udhëzimet dhe Parimet e KB mbi aksesin në ndihmë juridike në sistemin e drejtësisë penale specifikon se “ofruesit e ndihmës juridike që përfaqësojnë fëmijët duhet të marrin ‘trajnim bazik vazhdues multidisiplinar mbi të drejtat dhe nevojat e fëmijëve’, por gjithashtu dhe trajnim më të thelluar dhe të jenë të aftë të komunikojnë me fëmijët sipas nivelit të tyre të të kuptuarit”. (Udhëzimi 11, §58 d)

● PËRFITIMET DHE SFIDAT

Një nga pengesat kryesore që dekurajon avokatët nga pjesëmarrja në trajnime është se ato kërkojnë kohë dhe shpesh nuk janë pa pagesë. Përveç kësaj, në shumicën e rasteve, programet e trajnimit janë të fokusuara kryesisht në njohuri teorike sesa në aftësi praktike. Gjithashtu, është e vështirë të gesh një trajnim që kombinon ligjin, sociologjinë dhe psikologjinë, sidomos në trajnimin fillestar. Ndërkohë, është mungesa e më shumë trajnimeve specifike si barrierë madhore në specializimin e ofruesve të ndihmës juridike.

Në pothuajse të gjitha vendet e përfshira në studim, avokatët kanë opsionin e trajnimit

vazhdues në drejtësinë për të mitur. Megjithatë mungesa e programeve të detyrueshme mund të përbëjë një risk për cilësinë e shërbimit ligjor.

Trajnimi fillestar dhe vazhdues siguron cilësinë e ndihmës juridike, duke i ofruar pjesëmarrësve njohuri të specialiuara dhe të përditësuara.

Qasja multidisiplinare:

- Avokatët e intervistuar shfaqën interes të madh në këtë lloj trajnimi. Puna me fëmijët kërkon aftësi specifike që nuk mësohen tradicionalisht në leksionet e shkollës: si t'i drejtohesh fëmijës, si t'i kuptojmë ata dhe situatën e tyre, si të jemi empatik dhe të durueshëm, si t'i dëgjojmë ata etj.



- Ofruesit e ndihmës juridike duhet të kenë mjaftueshëm ekspertizë për të punuar me fëmijët në konflikt me ligjin. Kjo detyrë kërkon lloje të ndryshme aftësish të ndërlidhura. Aftësitë kyçe për tu zhvilluar gjatë këtij trajnimi janë njohuritë teorike (ligji për të mitur, të drejtat procedurale etj.) e po ashtu aftësitë praktike. Këto aftësi dhe njohuri nuk mund të mësohen në tërësinë e tyre gjatë trajnimit fillestar. Jo vetëm përmes eksperiencës, por edhe përmes trajnimit vazhdues, avokatit mund të ndalet e të mendojë në mënyrë kritike rreth praktikës së tij.
- Si trajnimi fillestar, ashtu edhe ai vazhdues duhet të kenë një qasje multidisiplinare.

Shembuj të trajnimeve që avokatët mund të ndjekin për të fituar aftësi praktike janë:

- Shkaqet sociale dhe të tjera të krimit
- Zhvillimi social e psikologjik i fëmijëve, duke përfshirë gjetjet më të fundit në neuroshkencë dhe zhvillimin e trurit të fëmijës
- Pabarazi që mund të çojnë në diskriminim ndaj disa grupeve të marxhinalizuara si fëmijët që i përkasin pakicave apo etnive të ndryshme
- Kultura dhe prirjet në botë të të rinjve
- Masa të disponueshme shmangeje dhe dënime jo me burim; në veçanti masa që shmangin proceset formale gjyqësore: drejtësia restauruese e riparuese⁶
- Të kuptojmë ndikimin e privimit nga liria në zhvillimin e fëmijës
- Trajnim në aftësitë komunikuese: si t'i adresohemi fëmijëve, si t'i kuptojmë ata dhe situatën e tyre, si të jemi empatik dhe të durueshëm, si t'i dëgjojmë ata etj.



• Në **Belgjikë**, avokatët që duan t'i bashkohen “seksionit të të miturve” duhet në fillim të jenë vullnetar në të. Pas kësaj, kërkesat e trajnimit fillestar përfshin ndjekjen e disa kurseve specifike për ligjin për të miturit. Për shembull, avokatët nga dhomat e avokatisë gjermanfolëse e frengjishtfolëse duhet të ndjekin një kurs afërsisht 80 - 100 orë që është në mënyrë të veçantë multidisiplinar. Ai përfshin psikologji, sociologji, kriminologji, ligj penal, ligj civil, ligj publik, si dhe ushtrime komunikimi me fëmijët ku përfshihen “luajtje rolesh”. Avokatët e dhomave frengjishtfolëse të avokatisë gjithashtu duhet t'i nënshtrohen trajnimit fillestar specifik në mënyrë që t'i bashkohen “seksionit të të miturve” të dhomës së tyre të avokatisë dhe nën këto kushte, ata lejohen të përfaqësojnë fëmijët. Më pas, nëse ata duan të vazhdojnë të përfaqësojnë të miturit, ata kanë detyrimin për të ndjekur trajnimin vazhdues. Ata duhet të kalojnë një numër të caktuar orësh në të mësuarin vazhdues që është domethënës për praktikën e tyre ligjore me të miturit. Përndryshe, ata largohen nga lista e Avokatëve të Fëmijëve.

27. Komunikimi miqësor me fëmijët

Një ndërveprim pozitiv me fëmijën është thelbësor për një asistencë juridike efektive

• STANDARTET E BE-SË DHE NDËRKOMBËTARE

Udhëzuesi i KE për Drejtësinë Miqësore me Fëmijët shprehet se “avokatët që përfaqësojnë fëmijët duhet të (...) jenë në gjendje të komunikojnë me fëmijët në nivelin e tyre të të kuptuarit”. Gjithashtu, Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, Komenti i Përgjithshëm mbi të Drejtat e Fëmijës, Komenti i Përgjithshëm nr. 10 mbi të Drejtat e Fëmijëve në Drejtësinë për të Mitur vë në dukje se fëmija duhet të informohet në një gjuhë që ai/ajo e kupton. Kjo mund të kërkojë “një përkthim” të zhargonit ligjor formal që përdoret shpesh në akuzat penale në një gjuhë të kuptueshme për fëmijën.

• PËRFITIMET DHE SFIDAT

Për të komunikuar efektivisht me një fëmijë, avokatët kanë nevojë të përshtasin një qasje të ndryshme nga ajo që përdoret me të rritur, e cila shumë shpejt nuk është e thjeshtë. Një stil komunikimi miqësor me fëmijët kontribuon si në mirëqënien emocionale, ashtu edhe në cilësinë e ndihmës juridike.

6 Një kurs e-learning mbi drejtësinë restauruese për fëmijët është i aksesueshëm në linkun vijues: <https://childhub.org/en/online-learning-materials/alternative-ways-address-youth>



- Për të komunikuar efektivisht me një fëmijë, avokatët duhet të marrin në konsideratë moshën e fëmijës, gjininë, aftësinë fizike dhe/ose mendore, stadin zhvillimor, gjendjen emocionale, nivelin e edukimit dhe kulturën. Ata duhet të marrin gjithashtu në konsideratë që zhvillimi i fëmijës ndikohet nga eksperiencat e tyre dhe marrëdhëniet me të tjerët e rëndësishëm⁷.
- Është thelbësore që mënyra në të cilën një avokat komunikon me një fëmijë të mos përforcojë çdo lloj aspekti diskriminues apo eksperiencë abuzive për fëmijën⁸.
- Mënyra më e mirë për të kërkuar një informacion të rëndësishëm për fëmijën dhe për ta bërë atë të relaksohet është përmes përdorimit të një interviste të strukturuar. Një model i një interviste të strukturuar ofrohet në pjesët në vijim të këtij kapitulli.
- **Takimi me fëmijët duhet të zhvillohet në një ambient komod dhe miqësor për fëmijën, si dhe që e bën atë të ndjehet i sigurtë dhe i çliruar.**
- Dhoma duhet të jetë sa më private të jetë e mundur. Të tjerët, që nuk janë të përfshirë në procesin e intervistës, nuk duhet të jenë në gjendje të dëgjojnë bisedën. Nuk duhet të ketë ndërprerje dhe njerëzit e tjerë nuk duhet të hyjnë në dhomë gjatë intervistës. Gjatë intervistës, letra dhe lapsa, stilolapsa mund të përdoren nga fëmija për të shkruar apo vizatuar diçka nëse ai/ajo dëshiron ta bëjë këtë. Adoleshentët mund të preferojnë të shkruajnë rrëfimin e tyre se çfarë ka ndodhur me fjalët e tyre ose t'i shkruajnë një letër Gjykatës. Të tjerë mund të ndjehen më komod duke dhënë dëshminë e tyre tek një profesionist ligjor verbalisht.
- Është shumë e rëndësishme që çdo individ i akuzuar se ka lënduar fëmijën, të **MOS** marrë pjesë në intervistë. Nëse është e mundur, një i rritur i besuar mund të jetë prezent gjatë intervistës, (për shembull një punonjës social ose një mësues) duke qenë se ai/ajo mund të mbështesë fëmijën nëse është e nevojshme. Sidoqoftë, është e rëndësishme që një person i besuar të mos përfshihet ose t'i përgjigjet pyetjeve në vend të fëmijës⁹.

“Është gjithashtu e nevojshme të buzëqeshni në fillim të bisedës dhe jo ta filloni atë me çfarë ka bërë fëmija” Avokat fëmijësh në Lituani

⁷ UNICEF. (2018). Guidelines on Child-Friendly Legal Aid. Gjetend në [në file \(unicef.org\)](https://www.unicef.org/)

⁸ Melinder, A., Magnusson, M., & Gilstrap, L. L. (2021). What Is a Child-Appropriate Interview? Interaction Between Child Witnesses and Police Officers. *International Journal on Child Maltreatment: Research, Policy and Practice*, 3, 369-392. doi.org/10.1007/s42448-020-00052-8

⁹ B. Mitchel. (2004). Let's Talk: Developing effective communication with child victims of abuse and human trafficking. Practical handbook for social workers, police, and other professionals. UNMIK, Government of Kosovo, UNICEF

28. Marrëdhënia e bazuar tek besimi

Avokati mbrojtës duhet të zhvillojë një marrëdhënie besimi me fëmijën

● STANDARTET E BE-SË DHE NDËRKOMBËTARE

Udhëzuesi i Këshillit të Europës për drejtësinë miqësore me fëmijët specifikon se zhvillimi i marrëdhënies së bazuar tek besimi mund të ndihmojë fëmijën të ndjehet i mirëkuptuar dhe i mbështetur: “Metodat miqësore me fëmijët duhet të bëjnë të mundur që fëmijët të ndjehen të sigurtë. Të qënë të shoqëruar nga një person i besuar i bën ata të ndjehen më komod gjatë procedurave.” Udhëzuesi i UNICEF mbi ndihmën juridike miqësore me fëmijët gjithashtu thekson se kjo është “baza e një përfaqësimi dhe asistence të një cilësie të mirë.” (Udhëzimi 4) Ai rekomandon që “të dedikohen kohë dhe burime për të ndërtuar një marrëdhënie të bazuar tek besimi me fëmijën për të kuptuar se çfarë është në interesin më të mirë të fëmijës.” (Udhëzimi 2)

● PËRFITIMET DHE SFIDAT

Të krijosh një marrëdhënie bashkëpunuese mund të jetë sfiduese për sa kohë shumë shpesh fëmijët esidomos adoleshentët, janë skeptikë rreth besnikërisë dhe kompetencës së avokatit. Në këtë rast, mund të marrë kohë për fëmijën të fitojë besim tek avokati, çka jo gjithmonë është e disponueshme brenda procedimit, apo për avokatin.

Një marrëdhënie bashkëpunuese redukton tensionin psikologjik të fëmijës, i motivon ata të bashkëpunojnë dhe rrit mundësinë e një mbrojtjeje më të mirë



- Para dhe gjatë intervistës me fëmijën, avokati duhet të zhvillojë një marrëdhënie bashkëpunuese me fëmijën. Ai/ajo duhet t'i shpjegojë se roli i tij/saj është i ndryshëm nga ai i të rriturve të tjerë në sistemin ligjor, si i prokurorëve ose gjyqtarëve, dhe se detyra e tij është t'i japë fëmijës ndihmën dhe përfaqësimin më të mirë.
 - Për aq sa është e mundur, fëmija duhet të asistohet nga i njëjti avokat mbrojtës nga fillimi deri në fund të procesit ligjor.
 - Avokati duhet të jetë i vetëdijshëm se eksperiencia e çdo fëmije është unike dhe e ndryshme nga ajo e të tjerëve. Natyra dhe dhënia e dëshmisë do të influencohet nga karakteri, kultura dhe niveli i të kuptuarit të fëmijës. Prandaj, avokati nuk duhet të bëjë supozime rreth asaj që një fëmijë nënkupton, por duhet të jetë i hapur ndaj versionit të fakteve të fëmijës dhe të përpiqet të kuptojë se çfarë ekzaktësisht fëmija do të thotë.
- Një element thelbësor në një marrëdhënie bashkëpunuese është krijimi i sensit të sigurisë emocionale, e cila zhvillohet përmes:
 - **Besimit:** një fëmijë ka nevojë të ketë besim tek avokati i tij. Prandaj, ju nuk duhet të gënjeni apo të keqdrejtoni fëmijën, apo t' i bëni premtime që nuk mund t'i mbani.
 - **Ndeshmërisë:** i thoni fëmijës të vërtetën në një mënyrë të përshtatshme për moshën, për shembull kur ai/ajo do të dijë se çfarë do të bëni ju me informacionin e marrë. Jini i vëmendshëm se fëmijët janë zakonisht shumë të mirë në leximin midis rreshtave, dhe ata nuk do t'ju besojnë nëse ju i largoheni pyetjeve.
 - **Qartësisë:** nëse fëmija shtron pyetje, (për shembull, për miqtë apo familjen) jepini përgjigje të detajuara në gjuhën që fëmija mund të kuptojë.
 - **Të qëniti i hapur:** ji i hapur rreth eksperiencës së fëmijës. Fëmijët zakonisht nuk krijojnë detaje false rreth historisë së tyre, por nganjëherë ata mund të kenë arsye për ta bërë këtë (p.sh. për të mbrojtur një mik apo një anëtar familje).¹¹

10 UNICEF op. cit., p 19

11 B. Mitchel op. cit., p 33

29. Prgatitja e intervistës me fëmijën

Për të mbledhur informacion të detajuar rreth fëmijës dhe çështjes, çdo intervistë që kryhet duhet të planifikohet mirë.

● STANDARTET E BE-SË DHE NDËRKOMBËTARE

Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijës Komenti i Përgjithshëm 24 mbi të Drejtat e Fëmijës në sistemin e drejtësisë për të mitur parashikon se fëmijës i duhet garantuar asistencë ligjore si dhe e llojeve të tjera që nga fillimi i procedimit, në prgatitjen dhe prezantimin e mbrojtjes, dhe derisa të gjitha apelimet e rishikimet janë ezauruar.

Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijës Komenti i Përgjithshëm 12 mbi të Drejtën e Fëmijës për tu Dëgjuar vë në dukje se një kohë dhe burime të përshtatshme duhet të jenë të disponueshme për të siguruar se fëmijët janë prgatitur siç duhet dhe kanë besim dhe mundësi për të kontribuar me mendimet e tyre. Konsideratë i duhet dhënë faktit se të gjithë fëmijët në nivele të ndryshme kanë nevojë për mbështetje dhe forma të përfshirjes në varësi të moshës dhe të kapaciteteve të zhvillimit.

The United Nations Committee on the Rights of the Child's **General Comment 12 on The Right of the Child to be Heard** highlights that adequate time and resources should be made available to ensure children are adequately prepared and have the confidence and opportunity to contribute their views. Consideration needs to be given to the fact that children will need differing levels of support and forms of involvement according to their age and evolving capacities.

● PËRFITIMET DHE SFIDAT

During the interview, a child's memory and suggestibility must be considered with caution. Children's ability to recall details of events can be very good but it can also easily be affected by stress related to the legal process.

Another important challenge the lawyer can have is the time allocated to meet his/her child client. For example, before a police hearing they might only have 20 minutes to conduct an interview, which is not enough to get to know the child and obtain sufficient information.

Taking the time to conduct an interview with the child allows the lawyer to build up the defence step-by-step, but also reassure the child and give him/her the necessary information to understand the procedure and its next steps.

A structured interview can also help the child to disclose sensitive information at his/her own pace.



- Për të kryer një bisedë sa më pak stresuese dhe për të rritur mundësinë e marrjes së informacionit nga fëmija, profesionisti ligjor duhet të përgatisë dhe të përdorë një intervistë të strukturuar¹².

SHEMBULL I NJË INTERVISTE TË STRUKTURUAR ME NJË FËMIJË

Hyrje në intervistë

Pyetjet e përgjithshme të hapura mund të jenë shumë ndihmëse për të vendosur një marrëdhënie me fëmijën. Ju mund të nisni bisedën me pyetje të përgjithshme si:

- *Më thoni rreth...*

- *Ushqimi juaj i preferuar*
- *Hobi juaj*

- *Më thuaj lidhur me çfarë të ndodhi kur.....'*

Atëherë, gradualisht zhvendosemi nga diskutimi më i përgjithshëm drejt çështjeve që lidhen me rastin në fjalë. Është e rëndësishme të lëvizim me hapin e fëmijës. Qëllimi është të krijojmë një tablo të qartë të historisë së fëmijës.

Pasi fëmija ka filluar të ndajë historinë e tij, ju duhet të dëgjoni me shumë kujdes dhe të tregoni se ju dëshironi të kuptoni dhe jeni të hapur ndaj asaj që ai/ajo thotë.¹³

Përpiquni të mos e ndërprisni rrjedhën e fakteve dhe përpiquni të merrni një tablo të plotë të eksperiencës së fëmijës. Pasi fëmija ka ardhur në një ndalesë të natyrshme, atëherë pyetjet specifike mund të bëhen përtë nxitur më shumë detaje.

Pyetje specifike janë **'çfarë', 'ku', 'kur', 'pse', 'si', 'kush'**, të cilat përdoren për të fituar më shumë detaje.

12 Robins, S.P. (2018). Forensic interviewing in Maschi, T. & Leibowitz, G. S. (Eds) Psychosocial and Legal Issues Across Diverse Populations and Settings, (2nd ed., pp 333-342), Springer Publishing Company LLC.

13 Robins, S. P. (2018). Forensic Interviewing, in Maschi, T. & Leibowitz, G. Forensic Social Work: Psychosocial and Legal Issues Across Diverse Populations and Settings (2nd ed., pp 333-342), Springer Publishing Company LLC.

Ji i vëmendshëm se pyetja “Pse? Duhet të bëhet me shumë kujdes, sepse mund të ndodhë që kur ju pyesni një person ‘Pse e bëre këtë?’ mund të tingëllojë sikur po e kritikoni dhe jo sikur po përpiqeni të kuptoni arsyen e veprimit. Nëse fëmija vihet në mbrojtje, përpiquni të pyesni me zë më të butë dhe në mënyrë më neutrale. Pse mendoni se ju e bëtë këtë? Çfarë të shtyu ta bëje? Pasi kemi pyetur pyetje specifike, mund të përdoren pyetjet e mbyllura. Pyetjet e mbyllura përdoren me kujdes në fund të intervistës për të qartësuar detaje të ngritura më herët në intervistë. Ky tip pyetjesh shtron alternative fikse apo pret përgjigje si “po” ose “jo”.¹⁴

Vëmendje:

- Mos bëj pyetje drejtuese; (psh. “më pas ti u ktheve të shohësh çfarë ndodhi, apo jo?”)
- Mos bëj njëkohësisht pyetje të shumëfishta;
- Mos përsërit të njëjtën pyetje shumë herë;
- Përdor pyetje të thjeshta, të rëndësishme;
- Shmang zhargonin ligjor/teknik;
- Mbjaj strukturën e intervistës, duke përdorur planin tënd si guidë. Mbjaj fëmijën në çështjet me rëndësi¹⁵;

Gjuha e trupit

Qëndrimi i trupit i përcjell fëmijës mesazhe negative ose pozitive. Me këtë qëllim, mbani në vëmendje sugjerimet e mëposhtme:

- Vendosni veten në nivel vështrimi me fëmijën;
- Shmangni zemërimin apo shprehje fytyrë që sugjerojnë gjykime negative;
- Shfaq një shprehje fytyre dhe mba kontakt të mirë me sy (por jo intimidues);
- Kujdesu që të shmangësh pozicione të tensionuara trupore;
- Mbjaj parasysh se pozicioni i trupit që ju përshtasni do të provokojë një përgjigje të caktuar nga fëmija.¹⁶

14 Andrews, S. J., Ahern, E. C., Stolzenberg, S. N., & Lyon, T. D. (2016). The productivity of wh- prompts when children testify. *Applied Cognitive Psychology*, 30(3), 341-349.

15 Snow, P., & Powell, M. (2018). Interviewing juvenile offenders: The importance of oral language competence. *Current Issues in Criminal Justice*, 16, 2, 220-225. doi.org/10.1080/10345329.2004.12036317

16 International Commission of Jurists. (2018). *Practical Handbook for Lawyers when Representing a Child: Training materials on access to justice for migrant children*, Module 6. Retrieved from Europe-FAIR-module-6-Training-modules-2018-ENG.pdf (icj.org)

Mbyllja e intervistës.

Pjesa përmbyllëse e intervistës është po aq e rëndësishme sa fillimi. Nëse fëmija ju ka besuar dhe ka ndarë me ju informacion delikat, kjo mund të ketë qenë hera e parë që fëmija ka ndjerë se një i rritur e ka besuar atë. Në fund të intervistës, mbaj në vëmendje se:

- Fëmija duhet lejuar të shtojë më shumë informacion nëse dëshiron, apo të modifikojë çdo gjë që mund të ketë thënë;
- Ju nuk duhet të tejzgjasi procedimet dhe të lodhni fëmijën, por as t'i bëni të ndjehen në nxitim;

Fundi i intervistës duhet të sigurojë që fëmija të largohet nga dhoma i mbështetur gjatë procesit hetimor¹⁷.

DISA AFTËSI DHE CILËSI TË NEVOJSHME KUR PUNOJMË ME ADOLESHENTË

- Të kesh njohuri të mirë për stadet zhvillimore të adoleshencës;
- Të jesh i aftë të vendosësh një marrëdhënie besimi pa qenë superior në të;
- Të jesh i hapur ndaj eksperiencave të adoleshentëve;
- Të jesh jo-gjykyes;
- Të pranosh emocionet jostabël tipike për adoleshencën;
- Të kuptosh efektet e mendimeve stres-provokuese për adoleshentët;
- Të jesh mbështetës¹⁸

17 Boyle, M & Vullierme, J. C. (2018). A brief introduction to investigative interviewing: A practitioner's guide. Council of Europe. Retrieved from ES233488_PREMS 108618 GBR 2015 Guide to investigative interviewing A5.pdf (coe.int)

18 B. Mitchel op. cit., p 47

30. Bashkëpunimi me familjen dhe profesionistë të tjerë në interesin më të lartë të fëmijës

Avokati mbrojtës duhet të bashkëpunojë ngushtësisht me të tjerë profesionistë dhe familjen dhe ky proces duhet të drejtohet nga interesi më i lartë i fëmijës.

● STANDARTET E BE-SË DHE NDËRKOMBËTARE

Siç theksohet në **Udhëzuesin e Këshillit të Europës mbi Drejtësinë Miqësore me Fëmijët**, “me respekt të plotë për të drejtën e fëmijës për jetë familjare dhe private, bashkëpunimi i ngushtë midis profesionistëve të ndryshëm duhet të inkurajohet për të arritur një të kuptuar gjithëpërfshirës të fëmijës, dhe një vlerësim të situatës së tij ligjore, psikologjike, sociale, emocionale, fizike e konjitive.” (§58)

Po ashtu, bashkëpunimi nuk kufizohet me profesionistët e tjerë. Bashkëpunimi me prindërit dhe të rriturit e tjerë të besuar është shumë i rëndësishëm për fëmijën dhe nëse ai/ajo ndjehet i mbështetur dhe i sigurtë, gjithmonë duke marrë në konsideratë nëse është në interesin e tij/saj më të lartë. Në këtë kuptim, Udhëzuesi i KE rekomandon se “Fëmijët duhet të lejohen të shoqërohen nga prindërit e tyre, kurdo që është e përshtatshme, nga një i rritur me zgjedhjen e tyre, përveç se kur një vendim i arsyetuar është marrë kundër atij personi” (§58)

Udhëzuesi i **UNICEF mbi ndihmën juridike miqësore me fëmijët** vë në dukje në udhëzimin nr.8 nevojën për të “punuar me anëtarët e familjes dhe të rritur të tjerë mbështetës.” Në këtë udhëzim, ai specifikon se “profesionisti mund të ketë nevojë të bashkëpunojë me të tjerë profesionistë për të arritur një të kuptuar të plotë të nevojave dhe dëshirave të fëmijës, si dhe risqeve që lidhen me vendimin.”

● PËRFITIMET DHE SFIDAT

Të tjerë profesionistë njihen si skeptikë ndaj avokatëve; ata shpesh perceptohen si kundërshtarë sesa si bashkëpunëtorë kur përfaqësojnë fëmijët. Gjithashtu, në disa raste ka një marrëdhënie konfliktuale midis fëmijës dhe prindërve apo të tjerëve të rritur.

Ndonëse institucionet e specializuara përfshihen në procesin ligjor, funksioni i tyre mbetet formal, dhe nuk ka një pjesëmarrje aktive. Gjithashtu, specialistët nuk janë mjaftueshëm të disponueshëm për të marrë pjesë në çdo procedim.

Bashkëpunimi midis profesionistëve është në disa raste i kufizuar nga vendimi i gjykatësit, i cili jo në çdo kohë e pranon atë.

Bashkëpunimi me profesionistë të tjerë si policë, prokurorë, gjyqtarë, përkthyes, punonjës social, psikologë, gjyqtarë, mësues dhe staf mjekësor e po ashtu anëtarë familjeje kontribuon në respektimin e të drejtës së fëmijës në një proces ligjor.

Veprimet bashkëpunuese mund të ndihmojnë gjithashtu avokatin në reduktimin e tensionit, që ai mund të ketë gjatë procesit ligjor.



- Profesionistët ligjor kanë një rol të rëndësishëm në inkurajimin e bashkëpunimit midis profesionistëve të ndryshëm në mënyrë që të zhvillohet një i kuptuar gjithëpërfshirës siç duhet i situatës së fëmijës dhe të plotësohen nevojat e fëmijës nga një qasje multidisiplinare. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastin e fëmijëve vulnerabël (p.sh. fëmijët në situatë rruge ose viktime të trafikimit njerëzor) të cilët kanë një seri problemesh që ndikojnë në situatën e tyre ligjore. Këto problem zakonisht kërkojnë forma të ndryshme asistence më shumë sesa thjesht ekspertizë ligjore. Prandaj, për të facilituar këtë proces, avokatët mbrojtës duhet:
 1. Të informohen mirë se si profesionistë të ndryshëm punojnë brenda sistemit ligjor në mënyrë që të jenë në gjendje t'i shpjegojnë rolin e tyre fëmijës si dhe nivelin e angazhimit të tyre.
 2. Të kenë një listë të përditësuar të ofruesve të shërbimeve që mund të nevojiten në një rast të caktuar.
 3. Të facilitojnë ndërveprimin midis fëmijës dhe profesionistëve të tjerë.
 4. Të ndjekin rregullisht sesione trajnimi se si të kenë një qasje multidisiplinare në trajtimin e rastit të një fëmije. Kjo do të synonte të krijonte një të kuptuar gjithëpërfshirës të rolit të profesionistëve të tjerë gjatë procesit ligjor.¹⁹
- Avokati duhet **të vendosë një marrëdhënie bashkëpunimi me anëtarët e familjes dhe të rritur të tjerë mbështetës**, pasi ata luajnë një rol të rëndësishëm për të siguruar që fëmija po mbështetet siç duhet gjatë procesit ligjor. Ata mund të japin gjithashtu një kontribut të rëndësishëm në riintegrimin e fëmijës pas dënimit.²⁰
- Në të njëjtën kohë, avokati duhet të jetë i vetëdijshëm se si marrëdhënia midis fëmijës dhe të rriturit mund të ndryshojë, duke rritur riskun e fëmijës për tu manipuluar. Është thelbësore që interesat e njerëzve të tjerë si prindër apo të rritur mbështetës të mos mbizotërojnë mbi interesin e fëmijës.²¹

¹⁹ UNICEF op. cit., p 29

²⁰ Young, M. C. (2000). Providing Effective Representation for Youth Prosecuted as Adults, Bureau of Justice Assistance, NCJ 182502.

²¹ Sterling, R. W. (2009). Role of Juvenile Defense Counsel in Delinquency Court. National Juvenile Defender Center. Retrieved from Role of Juvenile Defense Counsel in Delinquency Court (wa.gov)



Për fëmijët që përfshihen në procedime penale, shumica e vendeve Europiane ka ngritur një sistem mbrojtjeje që garanton respektimin e të drejtave të fëmijëve. Prandaj, profesionistët ligjor kanë akses me profesionistë të ndryshëm që mund të kontribuojnë për çështjen.

- Në Lituanë, kur një fëmijë përfshihet në procedime penale, Agjencisë së Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijës mund t'i kërkohet të marrë pjesë në seanca të marrjes në pyetje. Roli i tyre është të sigurojnë se të drejtat e fëmijës nuk shkelen.

31. Bashkëpunimi me një përkthyes

Kur fëmija nuk e kupton gjuhën e procedimit penal, një përkthyes duhet të jetë prezent.

● STANDARTET E BE-SË DHE NDËRKOMBËTARE

Direktiva e BE 2010/64 fokusohet në të drejtën e përkthimit në procedimet penale. Ajo nënvizon në nenin 2 të saj se “personat e dyshuar apo të akuzuar që nuk flasin dhe nuk kuptojnë gjuhën e procedimit penal përkatës i ofrohet pa vonesë, përkthimi gjatë procedimit penal, përpara autoriteteve hetimore dhe gjyqësore, duke përfshirë pyetjen në polici, të gjitha seancat gjyqësore dhe çdo dëgjese të nevojshme afatshkurtër. Paragrafi 2 specifikon se “përkthimi (duhet të jetë) i disponueshëm gjatë komunikimit midis personave të dyshuar apo akuzuar dhe avokatit të tyre (...)”.

● PËRFITIMET DHE SFIDAT

Përkthyesi i mundëson fëmijës të kuptojë arsyen pse ai/ajo është përfshirë në një procedim ligjor e po ashtu e informon atë për çdo gjë që lidhet me procesin ligjor.

Përkthyesit shpesh nuk gjenden lehtësisht: ka një risk të madh që ngadalëson procedurën dhe ndihmën juridike.

Në intervistat nga studimi i LA Child, avokatët shpesh thonë se përkthimi i dhënë fëmijëve ka qenë pamjaftueshëmrisht i saktë në termat e fjalorit ligjor dhe parimeve, si dhe jo gjithmonë është përdorur një ton i përshtatshëm për fëmijët. Nëse përkthyesi nuk është i kualifikuar për të punuar me fëmijët, ai/ajo mund ta intimidojë fëmijën ose të bëjë përkthim të papërshtatshëm të fjalëve të tij. Kjo gjithashtu mund të ndikojë për të penguar marrëdhënien e besimit midis avokatit dhe klientit të tij fëmijë.

Një tjetër sfidë e identifikuar nga studimi i LA Child është se kur fëmija kupton pak dhe flet pak gjuhën e procedimit, avokatët vëzhgojnë një tendencë nga ana e këtyre fëmijëve për të mos pyetur apo për të rënë dakort pa një përkthyes edhe kur aftësia

e tyre në atë gjuhë është e dobët, prandaj edhe në këto raste prezenca e përkthyesit është e nevojshme. Avokatët e intervistuar kanë vëzhguar një dëshirë nga ana e këtyre fëmijëve për tu dukur më bashkëpunues kur ata janë pa përkthyes.



Përkthimi

Kur fëmija nuk e kupton gjuhën e procedimit penal, ai/ajo duhet të asistohet nga një përkthyes gjatë të gjitha procedurave ligjore. Prandaj, avokati duhet të **bashkëpunojë ngushtësisht** me përkthyesin.

Për të garantuar që ky shërbim të ofrohet siç duhet, avokati duhet të fokusohet në pikat e mëposhtme:

- Kërkoni të keni një përkthyes në të gjitha takimet që përfshijnë fëmijën dhe profesionistë të tjerë që lidhen me çështjen si punonjës sociale apo psikologë²²;
- Kërkoni të keni një përkthyes për prindërit e fëmijës gjithashtu;
- Sigurohuni që përkthyesi ka kualifikimet e nevojshme dhe njohuritë për për të përkthyer në procedurat ligjore;
- Sigurohuni që përkthyesi nuk e influencon fëmijën;
- Bëjini të qartë përkthyesit se ai/ajo duhet të përkthejë vetëm atë që thotë fëmija, duke mos shtuar interpretime të panevojshme;
- Sigurohuni që përkthyesi nuk ndryshon fjalët e fëmijës për të përmirësuar fjalinë apo për të ofruar më shumë detaje;
- Sigurohuni se përkthyesi nuk ndërmerr iniciativa gjatë intervistës dhe fillon vetë të pyesë fëmijën. Ji i vëmendshëm që roli i përkthyesit të jetë neutral;
- Shpjegoji përkthyesit se ai/ajo duhet të mos shfaqë emocione personale si frikë apo zemërim. Këto reagime emocionale mund të ndikojnë fëmijën;
- Udhëzo përkthyesin që të flasë me një zë të qetë dhe të jetë jogjykues ndaj fëmijës²³

22 Fontes, L. A. (2010). Interviewing migrant children for suspected child maltreatment. *The Journal of Psychiatry and Law*, 38, 3. doi.org/10.1177/009318531003800304

23 Fontes, L. A. (2009). Interviewing Immigrant Children and Families for Suspected Child Maltreatment. American Professional Society on the Abuse of Children (APSAC). Retrieved from interviewing.pdf (brycs.org)



- ✳ Në **Francë**, lidhur me të drejtën për të patur një përkthyes, Kodi i Procedurës Penale parashikon që, nëse i akuzuari apo i dyshuari nuk e kupton frengjishten, ai/ajo ka të drejtën të asistohet nga një përkthyes gjatë seancave, si dhe për përkthimin e dokumentave të rëndësishme për mbrojtjen ligjore deri në fund të procedimit, përveç se kur ai/ajo ka shprehur se me vullnet heq dorë nga kjo e drejtë. Nëse ky shërbim ofrohet në kuadër të ndihmës juridike, ai është falas.
- ✳ Në mënyrë të ngjashme, përkthim falas përgjatë procedimeve ligjore është i disponueshëm në **Hungari, Austri, Republikën Çeke, Finlandë** dhe shumicën e vendeve europiane.

32. Fëmijët në nevojë për asistencë juridike të specializuar në fusha të ndryshme ligjore

Children in conflict with the law may need legal assistance in several areas of law. This is for example the case for children in migration situations who are also in conflict with the law. ● **STANDARTET E BE-SË DHE NDËRKOMBËTARE**

Parimet dhe Udhëzimet e KB të 2012 për ndihmën juridike të në sistemin e drejtësisë penale parashikojnë parimin e barazisë (parimi 10) “Masa të veçanta duhet të merren për të siguruar akses të plotë të grave, fëmijëve, dhe grupeve me nevoja të veçanta, duke përfshirë, por pa u kufizuar (...) minoritetet, (...), grupe autoktone etni te ndryshme, persona pa shtetëse, azilkërkues, qytetarë të huaj, emigrantë, refugjatë dhe persona të zhvendosur brenda vendit. Masa të tilla duhet të adresojnë nevojat e veçanta të këtyre grupeve, duke përfshirë, masa me ndjeshmëri gjinore dhe të përshtatshme për moshën.” (§32).

Udhëzuesi i Këshillit të Europës për drejtësinë miqësore me fëmijët specifikon se “Mbrojtje dhe asistencë specifike mund të nevojitet të jepet për fëmijët më vulnerabël si fëmijët migrant, refugjat, dhe azilkërkues, apo të pashoqëruar (...)” (III, D, 2) Udhëzuesi gjithashtu vë në dukje nevojën për trajnim në këto çështje në “Memorandumin Shpjegues” duke specifikuar se “të drejtat e fëmijëve mund dhe duhet të jenë pjesë e kurrikulës në shkolla dhe në fusha specifike të arsimit më të lartë (ligj, psikologji, etj.). Kjo duhet të mbulojë të drejtat e fëmijëve dhe legjislaclionin që i përket çështjeve të fëmijëve, si çështje familjare, drejtësi për të mitur, azil dhe ligj migracioni, etj. Shtetet Anëtare janë të inkurajuar të zhvillojnë kurse specifike trajnimi.” (§68).

● PËRFITIMET DHE SFIDAT

Kur një fëmijë është në konflikt me ligjin dhe cakton një avokat për këtë qëllim, avokati mund të jetë gjithashtu një ndihmë e madhe për fëmijën që ka nevojë për asistencë në procedime të natyrave të tjera, për shembull në procedime të lidhura me migrimin. Sidoqoftë, këto procedime të tjera janë zakonisht shumë specifike dhe kërkojnë avokatë shumë të specializuar. Për një fëmijë me nevojë për ndihmë juridike në një ose më shumë fusha të ligjit, të kesh një avokat që është kompetent në të gjitha fushat do t'i lejonte atij/asaj të shoqërohet e asistohet në mënyrën e duhur në procedime të ndryshme. Kjo do të shmangte gjithashtu prezencën e shumë avokatëve dhe do të rriste besimin. Gjithashtu, një fëmijë i përfshirë në lloje të ndryshme procedimesh do të takojë në fakt shumë aktorë të ndryshëm, rolin dhe funksionin e të cilëve, ai/ajo jo gjithmonë do ta kuptojë plotësisht. Një avokat i vetëm mund të shërbejë si një guidë për fëmijën dhe do ta drejtojë atë siç duhet. Megjithatë, në praktikë, është shumë e rrallë për të gjetur për shembull, avokatë që specializohen në ligjin e migracionit dhe në procedurat për fëmijët.



- Avokati i caktuar për një fëmijë në konflikt me ligjin duhet të marrë në konsideratë statusin administrativ të fëmijës dhe nëse ai/ajo ka nevojë për më shumë asistencë juridike në më shumë se një fushë. Nëse ky është rasti dhe avokati i përcaktuar fillimisht, nuk është kompetent në dy ose të gjitha fushat, ata duhet të ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar që fëmija do të përfaqësohet siç duhet në fushën/fushat e tjera po ashtu.
- Nëse fëmija ka më shumë se një avokat, ata duhet të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin.



- Në **Belgjikë**, disa avokatë të përfshirë në studimin e LA Child kishin vendosur të specializohen si në ligjin për mbrojtjen e fëmijëve (fëmijët në konflikt apo në risk për të qenë në konflikt me ligjin) dhe në ligjin e migracionit. Në këtë mënyrë, ata janë në gjendje të shoqërojnë klientët e tyre të rinj në një mënyrë gjithëpërfshirëse gjatë procedurave të ndryshme dhe të mbrojnë të drejtat e tyre.

STANDARTET KRYESORE EUROPIANE DHE NDËRKOMBËTARE LIDHUR ME NDIHMËN JURIDIKE PËR FËMIJËT NË KONFLIKT ME LIGJIN

Ekziston një numër i konsiderueshëm i teksteve ndërkombëtare, si të detyrueshme ashtu edhe jo të detyrueshme, për ndihmën juridike për fëmijët në konflikt me ligjin. Udhëzuesi aktual ka si qëllim të jetë një mjet praktik për tu zbatuar nga profesionistët. Më poshtë gjendet një listë e standarteve rajonale dhe ndërkombëtare. Gjithashtu, raporti për Ndhmën juridike për fëmijët në konflikt me ligjin në instrumentet kombëtare dhe ndërkombëtare ofron një vështrim të mirë në standartet ndërkombëtare, e si rezultat përfaqëson kërkesat më thelbësore për sistemet kombëtare të ndihmës juridike për u aksesuar dhe për tu përshtatur²⁴.

Legjislacion Zbatues

KOMBET E BASHKUARA

- International Covenant on Civil and Political Rights, UN General Assembly, 1966
- Convention on the Rights of the Child, UN General Assembly, 1989

KËSHILLI I EUROPËS

- European Convention on Human Rights, Council of Europe, 1950

BASHKIMI EUROPIAN

- Directive (EU) 2010/64/EU on the right to interpretation and translation in criminal proceedings, European Parliament and the Council, 2010
- Directive (EU) 2012/13/EU on the right to information on criminal proceedings, European Parliament and the Council, 2012
- Directive (EU) 2016/800 on procedural safeguards for children who are suspects or accused persons in criminal proceedings, European Parliament and Council, 2016

²⁴ Raporti është i aksesueshëm në website e projektit LA Child: <https://latchild.eu/the-projects/la-child/european-report/>

Legjislacion Jo Detyrues

KOMBET E BASHKUARA

- United Nations Principles and Guidelines on Access to Legal Aid in Criminal Justice Systems, United Nations Office on Drugs and Crime, 2012
- General comment No. 24 on children's rights in the child justice system, Committee on the rights of the child, 2019, CRC/C/GC/24

KËSHILLI I EUROPËS

- Guidelines of the Committee of Ministers of the Council of Europe on child-friendly justice, Council of Europe, 2010

BURIME TË TJERA

- Guidelines on child-friendly legal aid, UNICEF ECARO, 2018
- Handbook on Ensuring quality of legal aid services in criminal justice processes, United Nations Office on Drugs and Crime, 2019

LA CHILD



The project is funded by the Justice Programme of the European Union (2014-2020)

LA CHILD



The project is funded by the *Justice Programme of the European Union* (2014 – 2020)



With the support of *COCOF*